

**Važna napomena:** Prevod ovog propisa, odnosno akta sa srpskog jezika na albanski jezik, omogućila je Misija Organizacije za evropsku bezbednost i saradnju u Republici Srbiji (dalje: Misija OEBS u Srbiji) sa ciljem da se pripadnicima i pripadnicama nacionalne manjine, čiji je jezik u službenoj upotrebi u Republici Srbiji, omogući da se na svom jeziku i pismu obaveste i upoznaju sa sadržinom teksta propisa, odnosno akta koji je predmet ovog prevoda.

Misija OEBS u Srbiji posebno napominje da je isključivo i jedino pravno-relevantan i merodavan tekst propisa, odnosno akta (koji je predmet prevoda u ovom dokumentu) koji je objavljen na srpskom jeziku, u skladu sa i shodno propisu koji uređuje objavljivanje zakona i drugih propisa i akata u Republici Srbiji.

Za potrebe prevoda ovog propisa Misija OEBS u Srbiji angažovala je kompaniju Eurotranslate d.o.o. koja je u celosti, i u svemu prema pravilima struke, odgovorna i garantuje za jasnoću, preciznost, istinitost i tačnost izvršenog prevoda na albanski jezik. Misija OEBS u Srbiji ni po jednom osnovu nije odgovorna i ne garantuje za jasnoću, preciznost, istinitost i tačnost izvršenog prevoda.

**Shënim i rëndësishëm:** Përkthimin e kësaj dispozite, respektivisht akti nga gjuha serbe në gjuhën shqipe, e ka mundësuar Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian në Republikën e Serbisë (në tekstin e mëtejshëm: Misioni i OSBE-së në Serbi) me qëllim që pjesëtarëve dhe pjesëtareve të pakicës kombëtare, gjuha e të cilëve është në përdorimi zyrtar në Republikën e Serbisë, t'ua mundësojë që në gjuhën dhe shkrimin e tyre të informohen dhe të njihen me përmbajtjen e tekstit apo dokumentit, i cili është objekt i këtij përkthimi.

Misioni i OSBE-së në Serbi, në veçanti tërheq vërejtjen se teksti i rregullores, është ekskluzivisht teksti i vetëm ligjor-relevant dhe kompetent, respektivisht i aktit (i cili është objekt i përkthimit në këtë dokument), i cili është botuar në gjuhën serbe, në përputhje me dhe në pajtim me dispozitën që përcakton shpalljen e ligjit dhe dispozitave dhe akteve tjera në Republikën e Serbisë.

Për nevojat e përkthimit të kësaj dispozite, Misioni i OSBE-së në Serbi ka angazhuar kompaninë Eurocontract sh.p.k. e cila në tërësi, dhe sipas të gjitha rregullave të profesionit, është përgjegjëse për qartësinë, precizitetin, vërtetësinë dhe saktësinë e përkthimit të bërë në gjuhën shqipe. Misioni i OSBE-së në Serbi për asnjë arsye nuk është përgjegjës dhe nuk garanton për qartësinë, precizitetin, vërtetësinë dhe saktësinë e përkthimit të bërë.

# **LIGJ PËR KËSHILLAT KOMBËTARE TË PAKICAVE KOMBËTARE**

("Fl. zyrtare e RS", nr. 72/2009,  
20/2014 – vendimi i GJK dhe 55/2014)

## **I DISPOZITAT THEMELORE**

### **Neni 1**

Me këtë ligj rregullohen kompetencat e këshillave kombëtare të pakicave kombëtare (në tekstin e mëtejme: këshillat kombëtare) në fushën e kulturës, arsimit, informimit dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit, procedura e zgjedhjes së këshillave kombëtare, financimi i tyre dhe çështjet e tjera me rëndësi për punë të këshillave kombëtare.

### **Neni 2**

Për realizimin e të drejtave për vetëqeverisje në kulturë, arsim, informim dhe në përdorimin zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit, pjesëtarët e pakicave kombëtare në Republikën e Serbisë mund t'i zgjedhin këshillat e veta kombëtare.

Këshilli kombëtar e përfaqëson pakicën kombëtare në fushën e arsimit, kulturës, informimit në gjuhën e pakicës kombëtare dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit, merr pjesë në procesin e vendimmarrjes ose vendos për çështjet nga këto fusha dhe i themelon institucionet, shoqëritë ekonomike dhe organizatat e tjera nga këto fusha.

### **Neni 3**

Këshilli kombëtar regjistrohet në regjistër të këshillave kombëtare (në tekstin e mëtejme: Regjistri) të cilin e mban ministria në fushëveprimin e së cilës janë çështjet për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e pakicave (në tekstin e mëtejme: Ministria).

Këshilli kombëtar regjistrohet në Regjistër në bazë të fletëregjistrimit, të cilin kryetari i këshillit kombëtar ia paraqet Ministrisë brenda afatit prej pesë ditësh që kur legjislatura e parë e këshillit kombëtar e ka zgjedhur kryetarin e këshillit kombëtar.

Bashkë me fletëregjistrim dërgohet procesverbali nga seanca në të cilin është konstituuar legjislatura e parë e këshillit kombëtar, dy ekzemplarë të statutit të këshillit kombëtar dhe vendimi për zgjedhjen e kryetarit të këshillit kombëtar.

Këshilli kombëtar e fiton veçorinë e personit juridik me regjistrim në Regjistër.

Të dhënat të cilat janë regjistruar në Regjistër janë publike.

Mënyra e regjistrimit në Regjistër, mënyra e regjistrimit të ndryshimeve të të dhënave të cilat janë shënuar në Regjistër, mënyra e mbajtjes së Regjistrit dhe përmbajtjen dhe pamjen e fletëregjistrimit e përcakton ministri kompetent për të drejta të njeriut dhe të pakicave (në tekstin e mëtejme: ministri).

#### **Neni 4**

Aktvendimi me të cilin vendoset për fletëregjistrim për regjistrim në Regjistër miratohet brenda afatit prej 30 ditësh nga data e marrjes së fletëregjistrimit të rregullt.

Aktvendimi me të cilin vendoset për fletëregjistrim në Regjistër është definitiv dhe kundër tij mund të fillojë kontesti administrativ.

Këshilli kombëtar regjistrohet në Regjistër të njëjtën ditë kur merret aktvendimi për regjistrim në Regjistër.

Në Regjistër shënohet: emërtimi dhe selia e këshillit kombëtar; emri dhe mbiemri, vendbanimi dhe numri unik personal i kryetarit të këshillit kombëtar; data e miratimit të statutit dhe data e ndryshimeve dhe e plotësimeve të statutit; numri dhe data e aktvendimit për regjistrim dhe numri dhe data e aktvendimit për ndryshimin e të të dhënave në Regjistër.

Bashkë me aktvendim për regjistrim këshillit kombëtar i dërgohet një ekzemplar i statutit të cilin Ministria e vërteton me vulë të vet dhe me nënshkrim të nëpunësit të

autorizuar shtetëror, me çfarë konfirmohet origjinaliteti i tij me ekzemplarën e statutit i cili ruhet në Ministri.

#### **Neni 4a**

Këshilli kombëtar ka për detyrë që të paraqesë fletëregjistrimin e ndryshimeve të të dhënave të cilat janë regjistruar në Regjistër brenda afatit prej dhjetë ditësh nga dita e ndryshimit.

Bashkë me fletëregjistrim për shënimin e ndryshimit të të dhënave dërgohet edhe dëshmia për ndryshim, kurse bashkë me fletëregjistrim të ndryshimit dhe të plotësimit të statutit dërgohet procesverbali nga seanca në të cilën ndryshimet dhe plotësimet e statutit janë aprovuar edhe dy ekzemplarë të vendimit për ndryshimet dhe plotësimet e statutit.

Aktvendimi me të cilin vendoset për fletëregjistrim të ndryshimeve të të dhënave është definitiv dhe kundër tij mund të fillojë kontesti administrativ.

#### **Neni 4b**

Këshilli kombëtar shlyhet nga Regjistri:

- 1) nëse do të shpërndalet për shkak të ndaljes së procedurës së zgjedhjes së këshillit kombëtar;
- 2) nëse do të shpërndalet për shkak se numri i anëtarëve të tij është zvogëluar më shumë se gjysma.

Këshilli kombëtar shlyhet nga Regjistri të njëjtën ditë kur ministria e merr aktvendimin për shlyerjen nga Regjistri.

Aktvendimi për shlyerjen nga Regjistri është definitiv dhe kundër tij mund të fillojë kontesti administrativ.

Pakica kombëtare këshilli kombëtar i së cilës është shlyer nga Regjistri ka të drejtë të zgjedhë këshillin e ri kombëtar, në ditën kur të mbahen zgjedhjet për anëtarë të të gjitha këshillave kombëtare.

## **Neni 5**

Këshilli Kombëtar mund të fitojë dhe të tjetërsojë pronën e luajtshme dhe të paluajtshme, kurse në bazë të vendimit të organit kompetent mund të jetë edhe shfrytëzues i mjeteve në pronësi publike, në pajtim me ligjin.

## **Neni 6**

Këshilli kombëtar e ka statutin.

Me statut rregullohet:

- 1) veprimtaria e këshillit kombëtar;
- 2) numri i anëtarëve të këshillit kombëtar, në pajtim me ligjin;
- 3) selia e këshillit kombëtar;
- 4) emërtimi, simboli dhe vula e këshillit kombëtar;
- 5) autorizimet, procedura e zgjedhjes dhe mandati i kryetarit të këshillit kombëtar;
- 5a) autorizimet, procedura e zgjedhjes, numri i anëtarëve dhe mandati i këshillit ekzekutiv;
- 6) autorizimet, procedura e zgjedhjes, numri i anëtarëve dhe mandati i këshillit dhe i organeve të tjera punuese të këshillit kombëtar;
- 7) mirënjohjet dhe mënyra e ndarjes së tyre, dhe
- 8) çështjet e tjera me rëndësi për punë të këshillit kombëtar.

Legjislatura e parë e këshillit kombëtar ka për detyrë të miratojë statutin e këshillit kombëtar brenda afatit prej dhjetë ditësh nga dita kur është konstituuar.

## **II ÇËSHTJET E STATUSIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR**

### ***1. Organizimi i brendshëm i këshillit kombëtar***

## **Neni 7**

Këshilli kombëtar e ka kryetarin, këshillin ekzekutiv, këshillat për arsim, kulturë, informim dhe përdorimin zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit.

Kryetari i këshillit kombëtar e prezanton dhe e përfaqëson këshillin kombëtar.

Kryetari i këshillit kombëtar zgjedhet nga radha e anëtarëve të këshillit kombëtar.

Këshilli kombëtar e zgjedh kryetarin dhe anëtarët e këshillit ekzekutiv nga radha e anëtarëve të këshillit kombëtar, me propozim të kryetarit të këshillit kombëtar.

Këshilli kombëtar mund t'ia besojë këshillit ekzekutiv vendimmarrjen për çështje të veçanta nga kompetenca e këshillit kombëtar.

Vendimet të cilat i ka marrë kështu këshilli ekzekutiv i nënshtrohen miratimit në seancën e parë të ardhshme të këshillit kombëtar dhe miratohen nëse për to kanë votuar më shumë se gjysma e anëtarëve të këshillit kombëtar. Nëse këshilli kombëtar nuk e miraton vendimin e këshillit ekzekutiv, këshillit ekzekutiv i pushon mandati, kurse vendimi mbetet në fuqi.

## **Neni 8**

Puna e këshillit kombëtar është publike.

Këshilli kombëtar me vlerë të plotë vendos në seancën në të cilën janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të këshillit kombëtar.

Statuti, plani financiar dhe llogaria përfundimtare e këshillit kombëtar aprovohen nëse për to voton më shumë se gjysma e anëtarëve të këshillit kombëtar.

Kryetari i këshillit kombëtar dhe kryetari dhe anëtarët e këshillit ekzekutiv zgjedhen nëse për ta voton më shumë se gjysma e anëtarëve të këshillit kombëtar.

Kryetari i këshillit kombëtar dhe kryetari dhe anëtarët e këshillit ekzekutiv shkarkohen nëse për shkarkim voton më shumë se gjysma e anëtarëve të këshillit kombëtar.

Vendimet e tjera këshilli kombëtar i merr me shumicë të votave të anëtarëve të pranishëm.

## **2. Numri i anëtarëve të këshillit kombëtar**

### **Neni 9**

Këshilli kombëtar i ka jo më pak se 15, dhe jo më shumë se 35 anëtarë.

Në rast të pakicës kombëtare numri i së cilës sipas rezultateve të regjistrimit të fundit të popullsisë është më i vogël se 10.000 persona, këshilli kombëtar i numëron 15 anëtarë.

Në rast të pakicës kombëtare numri i së cilës sipas rezultateve të regjistrimit të fundit të popullsisë është më i madh se 10.000 por më i vogël se 20.000 persona, këshilli kombëtar i numëron 19 anëtarë.

Në rast të pakicës kombëtare numri i së cilës sipas rezultateve të regjistrimit të fundit të popullsisë është midis 20.000 dhe 50.000 persona, këshilli kombëtar i numëron 23 anëtarë.

Në rast të pakicës kombëtare numri i së cilës sipas rezultateve të regjistrimit të fundit të popullsisë është midis 50.000 dhe 100.000 persona, këshilli kombëtar i numëron 29 anëtarë.

Në rast të pakicës kombëtare numri i së cilës sipas rezultateve të regjistrimit të fundit të popullsisë është më i madh se 100.000 persona, këshilli kombëtar i numëron 35 anëtarë.

### **Neni 9a**

Mandati i këshillit kombëtar vijon nga konstituimi i këshillit kombëtar dhe zgjat derisa të skadojnë katër vjet nga konstituimi.

Para skadimit të kohës për të cilën është konstituuar, këshillit kombëtar mandati i pushon me shpërndarje.

Mandati i këshillit kombëtar i cili është konstituar pas shpërndarjes së këshillit kombëtar zgjat derisa të skadojë mandati i këshillit kombëtar i cili është shpërndarë.

Këshilli kombëtar të cilit i ka skaduar mandati i ushtron punët vijuese dhe të menjëhershme nga kompetenca e këshillit kombëtar derisa të konstituohet këshilli i ri kombëtar.

### III KOMPETENCAT E KËSHILLIT KOMBËTAR

#### ***1. Kompetencat e përgjithshme***

##### **Neni 10\***

Këshilli kombëtar, në pajtim me ligjin dhe me statutin e vet, përmes organeve të veta në mënyrë të pavarur:

- 1) e miraton dhe e ndryshon statutin e këshillit kombëtar;
- 2) e miraton planin financiar, raportin financiar dhe llogarinë përfundimtare;
- 3) disponon me pronë të vetë;
- 4) vendos për emërtimin, simbolet dhe vulën e këshillit kombëtar;
- 5) i përcakton propozimet e simboleve kombëtare, shenjave dhe të festave të pakicës kombëtare;
- 6) themelon institucione, shoqata, fondacione, shoqëri ekonomike në fushën e kulturës, arsimit, informimit dhe të përdorimit zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit;
- 7) i propozon përfaqësuesit e pakicës kombëtare në këshill për marrëdhënie ndërnacionale në njësi të vetëqeverisjes vendore;
- 8) përcakton dhe ndan mirënjohje;
- 9) inicon miratimin dhe e përcjell zbatimin e ligjit dhe të dispozitave të tjera nga fusha e kulturës, arsimit, informimit dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit;



10) merr pjesë në përgatitjen e dispozitave dhe propozon ndryshimin dhe plotësimin e dispozitave me të cilat rregullohen të drejtat e garantuara me Kushtetutë të pakicave kombëtare në fushën e kulturës, arsimit, informimit dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit;

11) propozon dispozita të veçanta dhe masa të përkohshme në fushat në të cilat realizohet e drejta për vetëqeverisje, për arritjen e barazisë së plotë midis pjesëtarëve të pakicave kombëtare dhe qytetarëve të cilët i takojnë shumicës;

12) e fillon procedurën para Avokatit të popullit, ombudsmanit krahinor dhe lokal dhe para organeve të tjera kompetente, kur vlerëson se është bërë shkelja e të drejtave dhe e lirive të pjesëtarëve të pakicave kombëtare të garantuara me Kushtetutë dhe me ligj.

13) e fillon procedurën nga pika 12) e këtij neni në emër të pjesëtarëve të pakicës kombëtare, duke e siguruar më parë autorizimin me shkrim;

14) merr qëndrime, fillon nisma dhe ndërmerr masa lidhur me të gjitha çështjet të cilat drejtpërsëdrejti janë të lidhura me pozitën, identitetin dhe të drejtat e pakicës kombëtare;

15) vendos për çështjet e tjera të cilat i janë besuar me ligj.

## ***2. Kompetencat në fushën e arsimit***

### **Të drejtat themeluese**

#### **Neni 11**

Këshilli kombëtar mundet, në pajtim me ligjin, të themelojë institucione të edukimit, arsimit, për mirëqenien sociale të nxënësve dhe të studentëve dhe të kryejë punët dhe obligimet e themeluesit.

Institucionet nga paragrafi 1, i këtij neni këshilli kombëtar i themelon në mënyrë të pavarur ose bashkë me Republikën, krahinën autonome, njësinë e vetëqeverisjes vendore ose me personin tjetër juridik në pajtim me ligjin.

Republika, krahina autonome dhe njësia e vetëqeverisjes vendore si themelues të institucioneve nga paragrafi 1, i këtij neni mundën në tërësi ose pjesërisht t'i kalojnë të drejtat themeluese në këshill kombëtar.

## **Pjesëmarrja në administrimin e institucioneve**

### **Neni 12\***

Në institucionet e edukimit dhe të arsimit parashkollor, fillor dhe të arsimit dhe të edukimit të mesëm themelues i të cilave është Republika, krahina autonome ose njësia e vetëqeverisjes vendore, në të cilat puna arsimoro-edukative zhvillohet edhe në gjuhën e pakicës kombëtare, ose në të cilat mësohet të folurit, gjuha ose kultura e pakicës kombëtare si lëndë e veçantë mësimore, këshilli kombëtar:

1) e jep mendimin për kandidatët e propozuar për anëtarë të këshillit administrativ, përkatësisht shkollor – përfaqësuesve të njësive të vetëqeverisjes vendore;

2) në institucione në të cilat në shumicën e paraleleve puna arsimoro-edukative zhvillohet në gjuhë të pakicës kombëtare, i propozon anëtarët e këshillit administrativ, përkatësisht shkollorë – përfaqësuesit e njësisë së vetëqeverisjes vendore;

3) e jep mendimin për kandidatin për drejtor të institucionit nga paragrafi 1, pika 1) e këtij neni;

4) e jep mendimin në procedurën e shkarkimit të drejtorit dhe të anëtarëve të organeve të administrimit në institucione nga paragrafi 1, pika 1) dhe 2) e këtij neni;

5)\* *(ka pushuar të vlejë me vendim të GJK)*

Në institucionet e mirëqenies sociale të nxënësve dhe të studentëve themelues i të cilave është Republika, krahina autonome ose njësia e vetëqeverisjes vendore, këshilli kombëtar:

1) e propozon një anëtar – përfaqësuesin e themeluesit dhe e jep mendimin për kandidatët e tjerë për anëtarë të këshillit drejtues të institucioneve të mirëqenies sociale të nxënësve selia e të cilëve është në territorin e njësisë së vetëqeverisjes

vendore në të cilin gjuha e pakicës kombëtare është në përdorim zyrtar. Nëse në njësi të vetëqeverisjes vendore më shumë gjuhë të pakicave kombëtare janë në përdorim zyrtar, këshillat kombëtare të interesuara e propozojnë kandidatin e përbashkët për anëtar të këshillit administrativ;

2) e jep mendimin për kandidatët për anëtarë të këshillave administrative të institucioneve të mirëqenies sociale të studentëve selia e të cilave është në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore në të cilën gjuha e pakicës kombëtare është në përdorim zyrtar.

3) e jep mendimin në procedurën e zgjedhjes së drejtorëve të institucioneve të mirëqenies sociale të nxënësve dhe të studentëve selia e të cilave është në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore në të cilin gjuha e pakicës kombëtare është në përdorim zyrtar;

4) e jep mendimin në procedurën e shkarkimit të drejtorëve dhe të anëtarëve të organit të administrimit nga paragrafi 2, pika 1) deri 3) e këtij neni.

Në fushën e arsimit të lartë në institucione themelues i të cilave është Republika, këshilli kombëtar e jep mendimin për kandidatët e propozuar për organe të udhëheqjes dhe të administrimit të institucionit të lartë shkollor në të cilin mësimi zhvillohet në tërësi ose pjesërisht në gjuhën e pakicës kombëtare.

## **Planet dhe programet mësimore**

### **Neni 13**

Këshilli kombëtar:

1) i propozon Këshillit Kombëtar për Arsim bazat e përgjithshme të programit parashkollor, planet dhe programet për arsimin dhe edukimin fillor dhe të mesëm dhe bazat e programit të edukimit, për përmbajtje të cilat e shprehin veçantinë e pakicës kombëtare, e sidomos nga fusha e historisë, edukimit muzikor dhe artit figurativ;

2) i propozon Këshillit Kombëtar të Arsimit programin e arsimit dhe të edukimit fillor dhe të mesëm për gjuhën e pakicës kombëtare dhe gjuhën, përkatësisht të folurit, e pakicës kombëtare me elemente të kulturës kombëtare;

3) ia jep mendimin Këshillit Kombëtar për Arsim për programet mësimore të gjuhës serbe, si gjuhë joamtare;

4) ia propozon ministrit kompetent për çështje të arsimit masat dhe programin e punës edukative me nxënësit në institucione të mirëqenies sociale, që kanë të bëjnë me afirmimin e tolerancës dhe multikulturalizmit ndëretnik;

5) e jep mendimin për programin shkollor dhe edukativ të institucioneve për të cilat është konstatuar se janë me rëndësi të veçantë për pakicë kombëtare.

### **Librat shkollorë dhe mjetet mësimore**

#### **Neni 14**

Nëse puna arsimoro-edukative realizohet në gjuhën e pakicës kombëtare, Këshilli Kombëtar për Arsim i propozon ministrit kompetent për çështje të arsimit dhënien e lejes për përdorim të librave shkollorë dhe të mjeteve mësimore përmbajtjet e të cilave i shprehin veçantitë e pakicës kombëtare bashkë me pëlqimin e mëparshëm të këshillit kombëtar.

Ministri kompetent për çështje të arsimit e jep lejen për përdorim të librave shkollorë të vendit ose të importuara në gjuhën e pakicës kombëtare për punë arsimoro-edukative, me propozimin e këshillit kombëtar.

### **Kompetencat e tjera në fushën e arsimit**

#### **Neni 15\***

Këshilli kombëtar në pajtim me ligjin:

1) e propozon një kandidat për listë të përbashkët të kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar për Arsim;

2) e jep mendimin në procedurën e miratimit të akteve për rrjetin e institucioneve parashkollore dhe të shkollave fillore në njësinë e vetëqeverisjes vendore në të cilën është në përdorim gjuha e pakicës kombëtare ose në të cilën zhvillohet puna arsimoro-edukative në gjuhën e pakicës kombëtare;

3) i përcakton institucionet arsimoro-edukative me rëndësi të veçantë për arsimimin e pakicës kombëtare; nëse numri i përgjithshëm i institucioneve është më i madh se katër, për institucionet me rëndësi të veçantë mund të shpallet më së shumti një e katërta nga numri i përgjithshëm i institucioneve në të cilat mësimi zhvillohet edhe në gjuhën e pakicës kombëtare; nëse numri i përgjithshëm i institucioneve të tilla është më i vogël se katër, institucion me rëndësi të veçantë mund të shpallet një nga institucionet në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën e pakicës kombëtare, përkatësisht edhe në gjuhën e pakicës kombëtare; në rast të pakicës kombëtare në gjuhën e së cilës nuk zhvillohet mësimi, rregullat nga kjo pikë kanë të bëjnë me institucionet në të cilat mësohet gjuha ose të folurit me elemente të kulturës së pakicës kombëtare;

4) ia jep mendimin ministrit kompetent për çështjet e arsimit në procedurën e përcaktimit të rrjetit të shkollave të mesme dhe të instituconeve të mirëqenies sociale për nxënës dhe për studentë;

5) ia jep mendimin ministrit kompetent për çështjet e arsimit në procedurën e dhënies së pëlqimit për ushtrimin e veprimtarisë së shkollës jashtë selisë së shkollës në të cilën mësimi zhvillohet në gjuhën e pakicës kombëtare;

6) i propozon themeluesit, Republikës, krahinës autonome ose njësisë së vetëqeverisjes vendore pavarësimin e paraleles së ndarë të shkollës në të cilën mësimi zhvillohet në gjuhën e pakicës kombëtare;

7)\* *(ka pushuar të vlejë me vendimin e GJK)*

8) ia jep mendimin ministrit kompetent për çështjet e arsimit në procedurën e dhënies së pëlqimit për hapjen e paraleleve në gjuhën e pakicës kombëtare për më pak se 15 nxënës;

9) institucioneve të mirëqenies sociale për nxënës ua jep mendimin në procedurën e ndarjes së vendeve në këto institucione;

10) e jep mendimin në procedurën e ndarjes së mjeteve nga buxheti i Republikës, krahinës autonome dhe i njësisë së vetëqeverisjes vendore të cilat ndahen përmes konkursit publik institucioneve dhe shoqatave në fushën e arsimit;

11) i cakton bursat nga mjetet e veta dhe me aktet e veta i përcakton kriteret dhe procedurën e vendimmarrjes për ndarjen e bursës dhe e zbaton procedurën për ndarje;

12) e përcakton përfaqësuesin në Këshillin Kombëtar për Arsim i cili merrë pjesë në punën e tij pa të drejtë për vendimmarrje, kur në gjuhën e pakicës kombëtare zhvillohet mësimi në kuadër të sistemit arsimor, kurse kur Këshilli Kombëtar për Arsim e shqyrton çështjet me rëndësi për formimin e pakicës kombëtare;

13) e përcakton përfaqësuesin e vet në Këshillin Kombëtar për Arsim të Lartë i cili është anëtar me të drejta të plota të këtij këshilli kur në gjuhën e pakicës kombëtare në tërësi ose pjesërisht zhvillohet mësimi në kuadër të arsimit të lartë;

14) i kryen edhe punët e tjera nga kjo fushë të përcaktuara me ligj ose me dispozita të tjera.

### **3. *Kompetencat në fushën e kulturës***

#### **Të drejtat themeluese**

##### **Neni 16**

Këshilli kombëtar mundet, në pajtim me ligjin, të themelojë institucione të kulturës për ruajtjen, përparimin dhe zhvillimin e veçantisë kulturore dhe ruajtjes së identitetit kombëtar të pakicës kombëtare dhe të kryejë të drejtat dhe obligimet e themeluesit.

Institucionet nga paragrafi 1, i këtij neni këshilli kombëtar i themelon në mënyrë të pavarur ose bashkë me Republikën, krahinën autonome, njësinë e vetëqeverisjes vendore ose me ndonjë person tjetër juridik, në pajtim me ligjin.

Republika, krahina autonome dhe njësia e vetëqeverisjes vendore si themelues të institucioneve nga paragrafi 1, i këtij neni mundet në tërësi ose pjesërisht t'i përcjellë të drejtat themeluese në këshill kombëtar.

#### **Pjesëmarrja në administrimin e institucioneve**

##### **Neni 17**

Në institucione të kulturës themelues i të cilave është Republika, krahina autonome ose njësia e vetëqeverisjes vendore, për të cilat këshilli kombëtar konstaton se janë me rëndësi të veçantë për ruajtjen e identitetit të pakicës kombëtare, këshilli kombëtar:

- 1) e emëron një anëtar të këshillit administrativ të institucionit;
- 2) e jep mendimin për anëtarët e propozuar të këshillit administrativ të institucionit;
- 3) e jep mendimin në procedurën e zgjedhjes së drejtorit të institucionit.

Nëse më shumë këshilla kombëtare konstatojnë se ndonjë institucion në fushën e kulturës është me rëndësi të veçantë për ruajtjen, përparimin dhe zhvillimin e veçantisë dhe të identitetit kombëtar të pakicës kombëtare, këshillat kombëtare e emërojnë nga një anëtar të këshillit administrativ nga paragrafi 1, pika 1) e këtij neni.

### **Kompetencat e tjera në fushën e kulturës**

#### **Neni 18**

Këshilli kombëtar:

- 1) e përcakton cilat institucione dhe manifestime në fushën e kulturës janë me rëndësi të veçantë për ruajtjen, përparimin dhe zhvillimin e veçantisë dhe të identitetit kombëtar të një pakice të caktuar kombëtare;
- 2) e përcakton strategjinë e zhvillimit të kulturës së pakicës kombëtare;
- 3) e konstaton cilat të mira kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme janë me interes të veçantë për pakicë kombëtare;
- 4) e fillon procedurën para organit kompetent ose institucionit për përcaktimin e statusit të të mirave kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme të mbrojtura me ligj me rëndësi për pakicë kombëtare;
- 5) propozon ndërmarrjen e masave mbrojtëse, sanacionit dhe rikonstruimit të të mirave kulturore nga paragrafi 1, pika 4) e këtij neni;

6) jep mendime dhe propozime në procedurën e hartimit të planeve hapësinore dhe urbanistike në njësinë e vetëqeverisjes vendore në të cilën gjenden të mirat kulturore nga paragrafi 1, pika 3) e këtij neni;

7) propozon ndaljen e ekzekutimit të planeve hapësinore dhe urbanistike nëse konsideron se me këtë rrezikohen të mirat kulturore nga paragrafi 1, pika 3) e këtij neni;

8) ia jep mendimin paraprak organit kompetent në procedurën e dhënies së lejes për zhvendosjen e të mirës kulturore të paluajtshme nga paragrafi 1, pika 3) e këtij neni në vendndodhje të re;

9) e jep mendimin në procedurën e themelimit ose të suprimimit të bibliotekave ose të njësive organizuese të bibliotekave të cilat e kanë fondin e librave në gjuhën e pakicës kombëtare;

10) e jep propozimin për ndarjen e mjeteve të cilat ndahen përmes konkursit publik nga buxheti i Republikës, krahinës autonome ose i njësisë së vetëqeverisjes vendore institucioneve, manifestimeve dhe shoqatave të pakicës kombëtare në fushën e kulturës;

11) e propozon më së paku një kandidat për listë të përbashkët për zgjedhjen e Këshillit Kombëtar për Kulturë;

12) e përcakton përfaqësuesin e vet në Këshillin Kombëtar për Kulturë i cili, pa të drejtë për vendimmarrje, merr pjesë në punën e tij kur shqyrtohen çështjet me rëndësi për kulturë të pakicës kombëtare;

13) vendos për çështjet e tjera të cilat i janë besuar me ligj, me akt të krahinës autonome ose të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

#### ***4. Kompetencat në fushën e informimit***

##### **Të drejtat themeluese**

##### **Neni 19\***



Këshilli kombëtar mundet, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, në mënyrë të pavarur ose bashkë me personin tjetër juridik, të themelojë institucione dhe shoqëri ekonomike për ushtrimin e veprimtarisë gazetare-botuese dhe radiotelevizive, shtypjes dhe riprodhimit të mediave të incizuara dhe të kryejë të drejtat dhe obligimet e themeluesit.

## **Pjesëmarrja në administrimin e institucioneve**

### **Neni 20**

Këshilli kombëtar :

1)-4)\* *(kanë pushuar të vlejnjë me vendimin e GJK)*

5) e jep mendimin për kandidatët për redaktor përgjegjës të programit në gjuhët e pakicave kombëtare në institucion të radiopërhapjes në të cilin emërohet redaktori përgjegjës për disa programe në gjuhët e pakicave kombëtare.

## **Kompetencat e tjera në fushën e informimit**

### **Neni 21**

Këshilli kombëtar :

1) e aprovon strategjinë e zhvillimit të informimit në gjuhën e pakicës kombëtare, në pajtim me strategjinë e Republikës së Serbisë;

2) i jep propozime Agjencisë Republikane të Radiopërhapjes me rastin e hartimit të Strategjisë së zhvillimit të radiopërhapjes;

3) e jep propozimin për ndarjen e mjeteve të cilat ndahen përmes konkursit publik nga buxheti i Republikës, krahinës autonome ose i njësisë së vetëqeverisjes vendore personave juridikë dhe fizikë të cilët kryejnë informimin në gjuhën e pakicës kombëtare;

4) i shqyrton raportet e Këshillit Administrativ dhe Progamor të Institucionit të Radiopërhapjes së Serbisë dhe të Institucionit të Radiopërhapjes së Vojvodinës dhe jep propozime dhe rekomandime për programet në gjuhën e pakicës kombëtare;

5) ia jep mendimin dhe propozimet Këshillit të Agjencisë Republikane të Radiopërhapjes, lidhur me informimin në gjuhën e pakicës kombëtare;

6) e cakton përfaqësuesin në Këshillin e Agjencisë Republikane të Radiopërhapjes i cili merr pjesë në punën e tij pa të drejtë për vendimmarrje, kur shqyrtohen çështjet lidhur me informimin në gjuhën e pakicës kombëtare;

7) ushtron edhe punë të tjera nga kjo fushë të përcaktuara me ligj dhe me akte të tjera.

### ***5. Kompetencat në fushën e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit***

#### **Neni 22**

Këshilli kombëtar :

1) i përcakton emërtimet tradicionale të njësive të vetëqeverisjes vendore, vendeve të banuara dhe emërtimeve të tjera gjeografike në gjuhën e pakicës kombëtare, nëse në zonën e njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të vendit të banuar është në përdorim zyrtar gjuha e pakicës kombëtare; emërtimet të cilat i ka përcaktuar këshilli kombëtar bëhen emërtime në përdorim zyrtar në gjuhën serbe dhe shpallen në "Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë", kurse në rastin e këshillave kombëtare selia e të cilave është në territorin e Krahinës Autonome të Vojvodinës në "Fletoren zyrtare të Krahinës Autonome të Vojvodinës";

2) i propozon organit kompetent theksimin e emërtimeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore, vendbanimeve të banuara dhe emërtimet e tjera gjeografike në gjuhën e pakicës kombëtare;

3) e propozon përcaktimin e gjuhës dhe të alfabetit të pakicës kombëtare si gjuhë dhe alfabet zyrtar në njësinë e vetëqeverisjes vendore;

4) propozon ndryshimin e emërtimit të rrugëve, shesheve, lagjeve të qytetit, lagjeve të fshatit, pjesëve të tjera të vendeve të banuara dhe institucioneve për të cilat është konstatuar se janë me rëndësi të veçantë për pakicë;

- 5) e jep mendimin në procedurën e përcaktimit të emërtimeve të rrugëve, shesheve, lagjeve të qytetit, lagjeve të fshatit dhe pjesëve të tjera të vendeve të banuara, nëse në zonën e njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të vendit të banuar gjuha e pakicës kombëtare është në përdorim zyrtar;
- 6) i propozon organit kompetent kryerjen e mbikëqyrjes mbi përdorimn zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit të pakicës kombëtare;
- 7) u propozon organeve kompetente masat dhe aktivitetet për përparimin e përkthimit të dispozitave në gjuhët e pakicave kombëtare të cilat janë në përdorim zyrtar;
- 8) ndërmerr masa dhe aktivitete për përparimin e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit të pakicës kombëtare;
- 9) vendos për çështjet e tjera nga kjo fushë të cilat i janë besuar me ligj, me akt të krahinës autonome ose të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

### **Nenet 23 dhe 24\***

*(Kanë pushuar të vlejnjë me vendim të GJK)*

## **IV RAPORTI ME ORGANET REPUBLIKANE, ORGANET E KRAHINËS AUTONOME DHE ORGANET E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE**

### **Raporti me organet republikane**

#### **Neni 25\***

Këshilli kombëtar mund t'u paraqesë organeve shtetërore dhe organizatave të veçanta propozime, nisma dhe mendime për çështjet nga kompetenca e vet.

Para shqyrtimit dhe vendimmarrjes për çështjet nga fusha nga paragrafi 2, i këtij ligji, organet nga paragrafi 1, i këtij ligji do të kërkojnë mendimin e këshillave kombëtare.

Këshilli kombëtar mund t'i paraqesë nismë Qeverisë për suprimim, përkatësisht anulim të akteve të organeve shtetërore dhe të organizatave të veçanta, të cilat nuk janë në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjeve të tjera dhe akteve të cilat kanë të bëjnë me pakicat kombëtare.

## **Raporti me organet e krahinës autonome dhe me organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore**

### **Neni 26\***

Këshillat kombëtare japin propozime, nisma dhe mendime për çështjet të cilat kanë të bëjnë me pozitën e pakicave kombëtare dhe me ruajtjen e veçantisë së pakicave kombëtare organeve të krahinës autonome dhe organeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

## **V BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE RAJONAL**

### **Neni 27\***

Këshilli kombëtar, në pajtim me ligjin, bashkëpunon me organizatat ndërkombëtare dhe rajonale, me organizatat dhe institucionet në shtetet amë, si edhe me këshillat kombëtare ose me organet e ngjashme të pakicave kombëtare në shtetet e tjera.

Përfaqësuesit e këshillave kombëtare marrin pjesë në biseda ose konsultohen lidhur me bisedat për lidhjen e marrëveshjeve bilaterale me shtetet amë, në pjesën e cila drejtpërsëdrejti ka të bëjë me të drejtat e pakicave kombëtare.

Përfaqësuesit e këshillave kombëtare marrin pjesë në punën e organeve të përziera ndërshtetërore detyra e të cilave është që të mbikëqyrin zbatimin e marrëveshjeve bilaterale ndërshtetërore për mbrojtjen e të drejtave të një pakice të caktuar kombëtare.

### **Neni 28**

Përfaqësuesit e pakicave kombëtare, përmes Këshillit të Republikës së Serbisë për pakica kombëtare, marrin pjesë në procedurën e lidhjes, përkatësisht nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare ose rajonale të cilat kanë të bëjnë me pozitën dhe me mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare.

## **VI ZGJEDHJA E KËSHILLAVE KOMBËTARE**

### ***1. Dispozitat e përbashkëta***

## **Neni 29**

Anëtarët e këshillit kombëtar zgjedhen në zgjedhje të drejtpërdrejta ose përmes kuvendit elektoral.

Zgjedhjet e drejtpërdrejta për anëtarë të këshillave kombëtare mbahen kur 24 orë para shpalljes së zgjedhjeve në listë të veçantë të zgjedhjeve të pakicës kombëtare janë regjistruar më shumë se 40% e pjesëtarëve të pakicës kombëtare sipas regjistrimit të fundit të popullsisë.

Për përcaktimin se a janë plotësuar kushtet për zgjedhje të drejtpërdrejta, Ministria përkohësisht i mbyll listat e veçanta të zgjedhjeve votimit të pakicave kombëtare 24 para shpalljes së zgjedhjeve.

Zgjedhjet përmes kuvendit elektoral mbahen nëse nuk janë plotësuar kushtet për zgjedhje të drejtpërdrejta edhe nëse pas shpërndarjes së këshillit kombëtar zgjedhjet e reja shpallen brenda afatit prej 60 ditësh nga shpërndarja.

## **Parimet e zgjedhjes së këshillave kombëtare**

### **Neni 30**

Zgjedhjet për këshill kombëtar bazohen në parimet e lirisë së zgjedhjes, barazisë së të drejtës zgjedhore, periodicitetit të zgjedhjes dhe parimit të votimit të fshehtë.

Parimet e veçanta janë vullnetarizmi, përpjestueshmëria dhe demokratizmi.

## **E drejta zgjedhore**

### **Neni 31**

E drejta zgjedhore e pjesëtarëve të pakicave kombëtare për zgjedhjen e këshillave kombëtare e nënkupton të drejtën që pjesëtari i pakicës kombëtare mund: të zgjedhë anëtarët e këshillit kombëtar, të zgjedhet për anëtar të këshillit kombëtar, të propozojë kandidatët për anëtarë të këshillit kombëtar, të jetë i informuar për zgjedhjet për këshilla kombëtare, për kandidatët për anëtarë të këshillit kombëtar, si edhe për programet e tyre, të regjistrohet në listë të veçantë të zgjedhjeve të pakicës

kombëtare, të votojë për zgjedhjen e këshillit kombëtar dhe të ketë të drejtën për mbrojtjen e të drejtave lidhur me zgjedhjen e këshillit kombëtar.

## **E drejta aktive elektorale**

### **Neni 32**

Pjesëtari i pakicës kombëtare e fiton të drejtën të zgjedhë anëtarët e këshillit kombëtar nëse i plotëson kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj për fitimin e të drejtës aktive elektorale.

Kusht i veçantë për fitimin e të drejtës aktive elektorale për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit kombëtar është regjistrimi në listë të veçantë të zgjedhjeve të pakicës kombëtare, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Kusht i veçantë për fitimin e të drejtës aktive elektorale për zgjedhjen e këshillit kombëtar të pakicës kombëtare përmes kuvendit elektorale është statusi i elektorit, i cili fitohet sipas dispozitave të këtij ligji.

## **E drejta pasive elektorale**

### **Neni 33**

Për anëtar të këshillit kombëtar mund të zgjedhet pjesëtari i pakicës kombëtare i cili i plotëson kushtet nga neni 32, i këtij ligji dhe nuk e ushtron funksionin e gjykatësit, prokurorit ose gjykatësit të Gjykatës Kushtetuese.

## **Dispozitat e veçanta për votim**

### **Neni 34**

Votimi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit kombëtar organizohet vetëm në territorin e Republikës së Serbisë.

## **Shpallja e zgjedhjeve**

### **Neni 35**

Zgjedhjet për anëtarë të këshillit kombëtar me vendim i shpall ministri.

Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve për anëtarë të të gjitha këshillave kombëtare merret jo më herët se 120 ditë, dhe jo më vonë se 90 ditë para skadimit të mandatit të këshillit kombëtar i cili i fundit është konstituuar.

Kur këshilli kombëtar është shpërndarë, zgjedhjet e reja për anëtarë të tij shpallen brenda afatit prej 60 ditësh nga data e shpërndarjes dhe kështu mbahen gjatë 45 ditëve të ardhshme. Jashtëzakonisht, nëse nga shpërndarja e këshillit kombëtar deri me skadimin e mandatit të këshillit kombëtar kanë mbetur më pak se një vit, ministri i shpall zgjedhjet e reja për anëtarë të këshillit kombëtar njëkohësisht kur i shpall edhe zgjedhjet për anëtarë të të gjitha këshillave kombëtare kështu që ata mbahen të njëjtën ditë.

Zgjedhjet nuk shpallen nëse këshilli kombëtar shpërndahet për shkak të ndaljes së procedurës së zgjedhjes së anëtarëve të këshillit kombëtar ose për shkak se numri i anëtarëve të tij është zvogëluar nën gjysmën.

Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve përmban: mënyrën e zgjedhjeve (zgjedhjet e drejtpërdrejta ose zgjedhjet përmes kuvendit elektoral), numri i anëtarëve të këshillit kombëtar i cili zgjedhet, dispozitat për fillimin e afateve për veprime zgjedhore dhe dita e mbajtjes së zgjedhjeve.

Vendim për shpalljen e zgjedhjeve shpallet në "Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë" dhe ia dërgon Komisionit Republikan të Zgjedhjeve

## **Koha e mbajtjes së zgjedhjeve**

### **Neni 36**

Zgjedhjet për anëtarë të të gjitha këshillave kombëtare, por edhe për anëtarë të legjislaturës së parë të këshillit kombëtar mbahen të njëjtën ditë, me përjashtim kur pas shpërndarjes së këshillit kombëtar zgjedhjet e reja shpallen brenda afatit prej 60 ditësh nga shpërndarja.

Zgjedhjet duhet të mbahen jo më vonë se 15 ditë para skadimit të mandatit të këshillit kombëtar i cili i fundit është konstituuar.

## **Shpenzimet e zgjedhjeve**

## **Neni 37**

Mjetet financiare për zbatimin e zgjedhjeve të këshillit kombëtar sigurohen nga buxheti i Republikës së Serbisë, sipas specifikimit të shpenzimeve gjithsej të planifikuara të cilin me marrëveshje e përcaktojnë Ministria dhe Komisioni Republikan i Zgjedhjeve.

### **Pezullimi i procedurës së zgjedhjes së këshillit kombëtar**

#### **Neni 37a**

Ministria me aktvendim e pezullon procedurën e zgjedhjes së këshillit kombëtar nëse nuk është përcaktuar me këtë ligj numri më i vogël i elektorëve. Aktvendimi merret 25 ditë para kuvendit elektoral dhe shpallet në "Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë".

Aktvendimi i Ministrisë është definitiv dhe kundër tij mund të fillojë kontesti administrativ brenda afatit prej 24 orësh nga shpallja e aktvendimit. Gjykata administrative ka për detyrë që për padi të vendosë brenda afatit prej 48 orëve nga marrja e padisë.

Organet për zbatimin e zgjedhjeve me aktvendim e pezullojnë procedurën e zgjedhjes së këshillit kombëtar nëse:

- 1) në kuvendin elektoral nuk merr pjesë me këtë ligj numri i përcaktuar i elektorëve;
- 2) për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit kombëtar nuk paraqitet asnjë listë e kandidatëve;
- 3) asnjë listë e paraqitur e kandidatëve nuk do të shpallet;
- 4) nëse për shkak të shkaqeve të përcaktuara me këtë ligj nuk do të përcaktohet lista shumëmemërore për zgjedhje.

Kur aktvendimi për pezullimin e procedurës së zgjedhjes së këshillit kombëtar të cilin e ka marrë organi për zbatimin e zgjedhjeve bëhet i plotëfuqishëm, për të njohtohet Ministria.



## **Organizimi i zgjedhjeve**

### **Neni 38**

Të gjitha punët e organizimit dhe të zbatimit të zgjedhjeve për këshilla kombëtare i kryejnë Ministria dhe organet për zbatimin e zgjedhjeve, në pajtim me këtë ligj.

### **Obligimet e mjeteve të informimit publik lidhur me zgjedhjet e këshillave kombëtare**

### **Neni 39**

Mjetet e informimit publik kanë për detyrë që, në pajtim me ligjin, të përcjellin rrjedhën e aktiviteteve të zgjedhjeve dhe të raportojnë për zgjedhjet e këshillave kombëtare.

Për informim lidhur me zgjedhjet e këshillave kombëtare konform aplikohen ligjet të cilat e rregullojnë informimin publik në procedurën e zgjedhjeve.

### **Shpërndarja e këshillit kombëtar dhe organet e përkohshme të administrimit**

### **Neni 40**

Ministri e shpërndan këshillin kombëtar:

- 1) nëse legjislatura e re e këshillit kombëtar nuk do të konstituohet brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e përcaktimit të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve;
- 2) nëse procedura e zgjedhjes së këshillit kombëtar do të pezullohet;
- 3) nëse këshilli kombëtar nuk mban mbledhje më gjatë se gjashtë muaj;
- 4) nëse këshilli kombëtar nuk e zgjedh kryetarin e këshillit kombëtar brenda afatit prej 30 ditësh nga konstituimi i këshillit kombëtar ose nga pushimi i funksionit të kryetarit të mëparshëm;
- 5) nëse numri i anëtarëve të këshillit kombëtar zvogëlohet nën gjysmën.

Këshilli kombëtar konsiderohet i shpërndar kur Ministria e merr aktvendimin për këtë.

Aktvendimi për shpërndarjen e këshillit kombëtar është definitiv dhe kundër tij mund të fillojë kontesti administrative.

Ministria me aktvendim e formon organin e përkohshëm të administrimit të këshillit kombëtar nga radha e anëtarëve të këshillit kombëtar, duke pasur kujdes për përfaqësimin e listave të kandidatëve nga të cilat janë zgjedhur anëtarët e këshillit kombëtar. Organin e përkohshëm të këshillit kombëtar e përbëjnë kryetari dhe katër anëtarë.

Deri me konstituimin e legjislaturës së re të këshillit kombëtar punët vijuese dhe të menjëhershme nga kompetenca e këshillit kombëtar i kryen organi i përkohshëm i administrimit të këshillit kombëtar.

Aktvendimi me të cilin formohet organi i përkohshëm i administrimit të këshillit kombëtar është definitiv dhe kundër tij mund të fillojë kontesti administrativ.

Organi i përkohshëm i administrimit të këshillit kombëtar nuk formohet kur këshilli kombëtar shpërndahet për shkak të pezullimit të procedurës së zgjedhjes së këshillit kombëtar ose për shkak se numri i anëtarëve të tij është zvogëluar nën gjysmë.

## **Mandati i anëtarëve të këshillit kombëtar dhe pushimi i anëtarësisë në këshillin kombëtar**

### **Neni 41**

Anëtarit të këshillit kombëtar mandati i zgjat aq sa zgjat mandati i këshillit kombëtar në të cilin është zgjedhur.

Anëtarit të këshillit kombëtar mandati i pushon para skadimit të mandatit të këshillit kombëtar në të cilin është zgjedhur:

- 1) me dhënien e dorëheqjes;
- 2) me humbjen e njërit prej kushteve të përgjithshme për fitimin e të drejtës aktive elektorale;
- 3) nëse më gjatë se një vit nuk merr pjesë në seanca të këshillit kombëtar;

4) nëse i pushon vendbanimi në territorin e Republikës së Serbisë;

5) nëse me vendim definitiv të organit kompetent është shlyer nga lista e veçantë e votimit e pakicës kombëtare;

6) nëse me aktvendim të plotëfuqishëm është dënuar për vepër penale me dënim me burg në kohëzgjatje më të gjatë se gjashtë muaj;

7) në rast të vdekjes.

Anëtari i Këshillit kombëtar ka për detyrë ta vërtetojë dorëheqjen te organi kompetent për vërtetimin e nënshkrimit dhe që këshillit kombëtar t'ia paraqesë brenda afatit prej tri ditësh nga vërtetimi, drejtpërsëdrejti ose me postë me rekomandim.

Pushimin e mandatit të anëtarit të këshillit kombëtar e konstaton këshilli kombëtar në seancën e parë të ardhshme pas marrjes së njohtimit për krijimin e shkaqeve për pushimin e mandatit.

Për pushimin e mandatit të anëtarit të këshillit kombëtar para skadimit të mandatit të këshillit kombëtar në të cilin është anëtar, kryetari i këshillit kombëtar e njohton Komisionin Republikan të Zgjedhjeve dhe Ministrinë.

Kur anëtarit të këshillit kombëtar i pushon mandati para skadimit të mandatit të këshillit kombëtar në të cilin është anëtar, mandati i ndahet kandidatit tjetër të parë nga lista e kandidatëve në të cilën ka qenë anëtar i cilit i ka pushuar mandati.

Anëtari i këshillit kombëtar zgjedhet për katër vjet dhe mund të rizgjedhet përsëri për anëtar të këshillit kombëtar.

Anëtarit të këshillit kombëtar i pushon mandati me konstituimin e legjislaturës së re të këshillit kombëtar.

## **Neni 42**

*(Është hequr)*

**Aplikimi konform me ligjet e tjera**

## **Neni 43**

Për zgjedhjen e këshillit kombëtar dhe çështjet të cilat nuk janë rregulluar me këtë ligj, konform aplikohen dispozitat e Ligjit për zgjedhjen e deputetëve të popullit, Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative dhe Ligjit për kontest administrativ.

### ***2. Zgjedhjet e drejtpërdrejta të anëtarëve të këshillave kombëtare***

#### **Listat e zgjedhjeve**

## **Neni 44**

Listën e veçantë të zgjedhjeve të pakicës kombëtare (në tekstin e mëtejshëm: lista e veçantë e zgjedhjeve) e formon Ministria, me kërkesë për formimin e listës së veçantë të zgjedhjeve, të cilën duhet ta mbështesin jo më pak se 5% e pjesëtarëve të moshës madhore të pakicës kombëtare sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, por që numri i tyre nuk mund të jetë më i vogël se 300.

Deklarata për mbështetjen e kërkesës për formimin e listës së veçantë të zgjedhjeve jepet në formular të përcaktuar dhe vërtetohet te organi kompetent për vërtetimin e nënshkrimeve.

Formën dhe përmbajtjen e formularit të deklaratës për mbështetjen e kërkesës për formimin e listës së veçantë të zgjedhjeve e përcakton ministri.

Për kërkesën për formimin e listës së veçantë të zgjedhjeve Ministria vendos me aktvendim.

Ministria e refuzon kërkesën për formimin e listës së veçantë të zgjedhjeve nëse paraqitësi i kërkesës nuk konsiderohet pakicë kombëtare në pajtim me ligjin ose nëse kërkesën nuk e ka mbështetur numri i nevojshëm i pjesëtarit të pakicës kombëtare.

Aktvendimi i Ministrisë i marrë sipas kërkesës për formimin e listës së veçantë të zgjedhjeve është definitiv dhe kundër tij mund të fillojë kontesti administrativ.

Kërkesa dhe vërtetimi i nënshkrimit nuk i nënshtrohen pagimit të taksës.

## **Neni 45**

Ministria i njohton përmes mjeteve të informimit publik pjesëtarët e pakicës kombëtare nga neni 44, i këtij ligji se ka filluar formimi i listës së veçantë të zgjedhjeve.

## **Neni 46**

*(Hiqet)*

## **Rregullat e përgjithshme për listën e veçantë të zgjedhjeve**

## **Neni 47**

Listë e veçantë e zgjedhjeve është evidenca zyrtare në të cilën shënohen pjesëtarët e pakicës kombëtare të cilat kanë të drejtë votimi.

Lista e veçantë e zgjedhjeve është e përhershme dhe përditësohet rregullisht.

Pjesëtari i pakicës kombëtare regjistrohet në listë të veçantë të zgjedhjeve vetëm me kërkesë të vetë.

## **Neni 48**

Listën e veçantë të zgjedhjeve e mban Ministria.

Mbajtja e listës së veçantë të zgjedhjeve përfshin: analizimin e të dhënave nga lista e veçantë e zgjedhjeve dhe ndërmarrjen e masave për harmonizimin e ndërsjellë dhe saktësinë e të dhënave dhe regjistrimin dhe ndryshimet në listën e veçantë të zgjedhjeve (shlyerja, ndryshimet, plotësimet ose korrigjimet) nga mbyllja e listës së veçantë të zgjedhjeve dhe ushtrimi i punëve të tjera të përcaktuara me këtë ligj.

Në pjesën e listës së veçantë të zgjedhjeve për zonën e njësisë së vetëqeverisjes vendore regjistrimi dhe ndryshimet në listë të veçantë të zgjedhjeve (shlyerja, ndryshimet, plotësimet ose korrigjimet) i bën drejtoria komunale, përkatësisht e qytetit, si punë që i është besuar, derisa të mbyllet lista e veçantë e zgjedhjeve. Në njësi të vetëqeverisjes vendore në të cilën në përdorim zyrtar është gjuha dhe alfabeti i pakicës kombëtare për të cilën mbahet lista e veçantë e zgjedhjeve,

regjistrimi dhe ndryshimet në listë të veçantë të zgjedhjeve bëhen edhe në gjuhën dhe alfabetin e saj, në pajtim me ligjin.

Listat e veçanta të votimit mbahen dhe përditësohen si bazë unike elektronike e të dhënave.

Ndryshimet në listë të veçantë të zgjedhjeve bëhen sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë.

Organi i cili e mban evidencën zyrtare për qytetarët ka për detyrë që Ministrisë dhe drejtorive komunale, përkatësisht të qytetit t'ua dërgojnë të dhënat të cilat ndikojnë në saktësinë e listës së veçantë të zgjedhjeve.

#### **Neni 49**

*(Është hequr)*

#### **Neni 50**

Lista e veçantë e zgjedhjeve përmban: numrin rendor, emrin personal, numrin e amzës, gjininë, përkatësinë kombëtare, vitin e lindjes, vendbanimin (rruga dhe numri i shtëpisë, fshati, lagjja e fshatit, qendrën e banimit) dhe hapësirën për vërejtje.

#### **Neni 51**

Të dhënat nga lista e veçantë e zgjedhjeve e gëzojnë mbrojtjen e veçantë.

Është e ndaluar dhe dënohet secili përdorim i të dhënave nga lista e veçantë e zgjedhjeve, me përjashtim për qëllim të zgjedhjeve dhe me qëllim të realizimit të drejtave të tjera të pakicave kombëtare, nëse kjo është përcaktuar me ligj.

#### **Neni 52**

Pjesëtarët e pakicës kombëtare regjistrohen në listë të veçantë të zgjedhjeve kur i plotësojnë kushtet e përgjithshme për fitimin e të drejtës së votimit të përcaktuar me ligj.

Pjesëtari i pakicës kombëtare mund të regjistrohet vetëm në një listë të veçantë të zgjedhjeve.

Secili qytetar me të drejtë vote, pjesëtar i pakicës kombëtare, mundet në formular të veçantë me shkrim të kërkojë të regjistrohet në listë të veçantë të zgjedhjeve.

Kërkesa për regjistrim në listë të veçantë të zgjedhjeve pjesëtari i pakicës kombëtare ia paraqet organit të administratës së njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas vendbanimit, në formën me shkrim, në formular të veçantë të cilin e përcakton ministri dhe e nënshkruan me dorë të vet.

### **Neni 53**

Shlyerja nga lista e veçantë e zgjedhjeve bëhet sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë.

Shlyerja nga lista e veçantë e zgjedhjeve sipas detyrës zyrtare bëhet në rast të vdekjes së pjesëtarit të regjistruar të pakicës kombëtare ose nëse pjesëtari i regjistruar i pakicës kombëtare (në tekstin e mëtejme: votuesi) e humb të drejtën e votimit për shkak se ka pushuar të plotësojë një nga kushtet e përgjithshme për fitimin e të drejtës së votimit të përcaktuara me ligj.

Votuesi e paraqet kërkesën për shlyerjen nga lista e veçantë e zgjedhjeve organit të administratës së njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas vendit të vendbanimit, në formular të veçantë të cilin e përcakton ministri, dhe e nënshkruan me dorë të vet.

### **Neni 54**

*(Është hequr)*

### **Neni 55**

Ministri e përcakton më hollësisht mënyrën e mbajtjes së listës së veçantë të zgjedhjeve dhe çështjet e tjera me rëndësi për mbajtjen e plotë, të saktë dhe të përditësuar të listës së veçantë të zgjedhjeve.

### **Neni 56**

Nëse në procedurë të regjistrimit në listë të veçantë të zgjedhjeve të shlyerjes nga lista, organi i administratës i njësisë së vetëqeverisjes vendore i cili e mban listën e votimit refuzon të bëjë regjistrimin e votuesit në listë të veçantë të zgjedhjeve ose shlyerjen nga lista, votuesi ka të drejtë t'i paraqesë ankesë Ministrisë. Aktvendimi i Ministrisë është definitiv dhe kundër tij mund të fillojë kontesti administrativ.

Ministria e merr aktvendimin për ankesë brenda afatit prej 15 ditësh.

### **Neni 57**

Pas mbylljes së listës së veçantë të zgjedhjeve, regjistrimi, shlyerja, ndryshimet, plotësimet dhe korrigjimet në listë të veçantë të votimi i bën Ministria, në bazë të aktvendimit të cilin e sjell jo më vonë se 72 orë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

Aktvendimi i Ministrisë është definitiv dhe kundër tij mund të fillojë kontesti administrativ.

### **Neni 58**

*(Është hequr)*

### **Neni 59**

Aplikimin e dispozitave me të cilat rregullohet mbajtja e listave të veçanta të votimit në njësitë e vetëqeverisjes vendore i mbikëqyr Ministria, përmes inspeksionit administrativ.

Nëse Ministria konstaton se lista e veçantë e zgjedhjeve nuk është duke u mbajtur siç është përcaktuar me ligj dhe me dispozita të tjera, e urdhëron organin kompetent që të mënjanojë parregullsitë e përcaktuara.

## **Organet për zbatimin e zgjedhjeve**

### **Neni 60**

Zgjedhjet e drejtpërdrejta për anëtarë të këshillit kombëtar i zbatojnë organet të cilat i zbatojnë zgjedhjet për deputetë të popullit.



Punën e organeve për zbatimin e zgjedhjeve mund ta mbikëqyrin përfaqësuesit e propozuesit të listave të shpallura të zgjedhjeve.

## **Neni 61**

*(Është hequr)*

## **Kompetenca e Komisionit Republikan të Zgjedhjeve**

## **Neni 62**

Kompetencat e Komisionit Republikan të Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) janë:

- 1) kujdeset për zbatimin e zgjedhjeve në bazë të ligjit;
- 2) organizon përgatitjen teknike për zgjedhje;
- 3) e përcjell aplikimin dhe jep sqarime lidhur me aplikimin e këtij ligji, lidhur me zgjedhjet;
- 4) i përcakton formularët dhe rregullat për zbatimin e veprimeve zgjedhore të përcaktuara me këtë ligj;
- 5) i cakton vendet e votimit dhe i publikon në "Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë", jo më vonë se 20 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve;
- 6) i formon këshillat e zgjedhjeve dhe e emëron kryetarin dhe anëtarët e këshillave të zgjedhjeve dhe zëvendësit e tyre;
- 7) i përgatit dhe i vërteton fletëvotimet;
- 8) e përcakton a është përbërë dhe a është paraqitur lista e kandidatëve në pajtim me ligjin dhe e shpall listën e kandidatëve;
- 9) e përcakton listën shumëmemërore për zgjedhjet e kandidatëve;
- 10) e miraton aktvendimin për pezullimin e zgjedhjes së anëtarëve të këshillit kombëtar nëse për zgjedhje të anëtarëve të këshillit kombëtar nuk paraqitet asnjë

listë e kandidatëve, nëse asnjë listë e paraqitur e kandidatëve nuk do të shpallet dhe nëse nga shkaqet e përcaktuara me këtë ligj nuk do të përcaktohet lista shumëmemërore e zgjedhjeve;

11) e përcakton mënyrën e ruajtjes dhe të veprimit me material të zgjedhjeve;

12) e përcakton dhe i publikon rezultatet e përgjithshme dhe përfundimtare të zgjedhjeve;

13) e përcakton numrin e mandateve të cilat i takojnë secilës listë të kandidatëve;

14) ua dërgon të dhënat organeve të cilat janë kompetente për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore;

15) e miraton udhëzimin për zbatimin e zgjedhjeve dhe i kryen punët e tjera të përcaktuara me këtë ligj.

Komisioni ka për detyrë që formularët nga paragrafi 1, pika 4) e këtij neni t'i publikojë brenda afatit prej pesë ditësh nga miratimi i vendimit për shpalljen e zgjedhjeve.

Për punë në zbatimin e zgjedhjeve, anëtarëve të Komisionit u takon kompensimi mujor në shumën e dy pagave mujore mesatare pa tatim dhe kontribute të paguara në Republikën e Serbisë në muajin i cili i paraprin muajit në të cilin është marrë vendimi për shpalljen e zgjedhjeve.

## **Neni 63 dhe 64**

*(Janë hequr)*

## **Përbërja e këshillit të zgjedhjeve**

### **Neni 65**

Këshillin e zgjedhjeve e përbëjnë kryetari dhe jo më pak se katër anëtarë.

Kryetari dhe anëtarët e këshillit të zgjedhjeve i kanë zëvendësit.

Komisionin e formon këshilli i zgjedhjeve dhe e emëron kryetarin, anëtarët dhe zëvendësit e tyre.

Anëtarët e këshillit të zgjedhjeve, organet punuese të Komisionit dhe punëtorët profesionalë në Shërbim të Kuvendit Popullor të cilët marrin pjesë në punën e organit për zbatimin e zgjedhjeve kanë të drejtë për kompensim për punë të cilin e përcakton Komisioni.

## **Kompetenca e këshillit të zgjedhjeve**

### **Neni 66**

Këshilli i zgjedhjeve drejtpërsëdrejti e zbaton votimin në vendvotim, e siguron rregullsinë dhe fshehtësinë e votimit, i konstaton rezultatet e votimit në vendvotim dhe ushtron edhe punë të tjera të caktuara me këtë ligj.

Këshilli i zgjedhjeve kujdeset për mbajtjen e rendit në vendvotim gjatë kohës së votimit.

Rregullat më të hollësishme për punën e këshillit të zgjedhjeve i përcakton Komisioni.

## **Qendrat e votimit**

### **Neni 67**

Votimi në zgjedhje zhvillohet në qendra të votimit të cilat i përcakton Komisioni.

### *Përcaktimi i qendrave të votimit*

### **Neni 68**

Qendra e votimit përcaktohet për votim jo më pak se 100, dhe jo më shumë se 2.500 zgjedhës të regjistruar në lista të veçanta të zgjedhjeve.

Jashtëzakonisht, qendra e votimit mund të caktohet edhe për votimin e më pak se 100 zgjedhësve nëse, për shkak të largësisë ose pozitës së pavolitshme gjeografike, zgjedhësit do ta kishin dukshëm më vështirë të votonin në ndonjë qendër tjetër të votimit.

Për qendra të votimit, sipas rregullit, përcaktohen hapësirat në pronësi publike, kurse vetëm në raste të jashtëzakonshme edhe hapësirat në pronësi private.

Qendër e votimit nuk mund të jetë në objekt i cili është në pronësi të partisë politike ose të cilin e përdor partia politike, as objekti i cili është në pronësi të kandidatit për anëtar të këshillit kombëtar ose për anëtar të familjes së tij. Me anëtar të familjes së kandidatit nënkuptohen prindërit etij, fëmijët dhe bashkëshorti.

Me rastin e caktimit të qendrës së votimit, duhet pasur parasysh që qendra e votimit të jetë vend ku personat me invaliditet mund të votojnë lehtë.

### **Neni 69**

*(Është hequr)*

*Rregullimi i qendrës së votimit*

### **Neni 70**

Rregullat lidhur me rregullimin e qendrës së votimit i përcakton Komisioni.

### **Kandidimi – listat e kandidatëve**

### **Neni 71**

Listat e kandidatëve munden, nën kushte të përcaktuara me këtë ligj, t'i propozojë grupi i zgjedhësve të regjistruar në listë të veçantë të zgjedhjeve, shoqatat qëllimet e të cilave realizohen në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pakicës kombëtare dhe partisë së regjistruar politike të pakicës kombëtare (në tekstin e mëtejme: propozuesi).

Grupin e zgjedhësve e formojnë më së paku tre zgjedhës me marrëveshje me shkrim te organi kompetent për verifikimin e nënshkrimeve. Marrëveshja për formimin e grupit të zgjedhësve përmban qëllimet e formimit të grupit të zgjedhësve, të dhënat për personat të cilët e kanë formuar (emri dhe mbiemri, numri i unik i amzës i qytetarëve dhe vendbanimi, sipas të dhënave nga letërnjohtimi). Me marrëveshje patjetër përcaktohet personi i cili e përfaqëson grupin e qytetarëve.

Listën e kandidatëve me nënshkrimet e veta duhet ta mbështesin jo më pak se 1%, dhe jo më shumë se 50 zgjedhës në listë të veçantë të zgjedhjeve.

Votuesi mundet me nënshkrim të vet të mbështesë listën e kandidatëve vetëm të një propozuesi.

Nënshkrimet për përkrahje duhet të jenë të vërtetuara te organi kompetent për verifikim të nënshkrimeve. Vërtetimi i nënshkrimit nuk i nënshtrohet pagimit të taksës.

Listën e kandidatëve mund ta paraqesë përfaqësuesi i propozuesit të listës së kandidatëve ose personi të cilin e autorizon ai.

Personi i cili është i autorizuar ta paraqesë listën e kandidatëve, është i autorizuar që në emër të propozuesit të listës së kandidatëve të ushtrojë të gjitha veprimet e tjera në zgjedhje, nëse propozuesi i listës së kandidatëve nuk e cakton më ndryshe.

#### *Lista e kandidatëve - struktura*

### **Neni 72**

Në listën e kandidatëve duhet të gjendet jo më pak se një e treta e kandidatëve nga numri i anëtarëve të këshillit kombëtar i cili zgjedhet, dhe jo më shumë se aq kandidatë sa anëtarë të këshillit kombëtar zgjedhen.

Kandidat mund të jetë vetëm ai person i cili është regjistruar në listë të veçantë të zgjedhjeve.

Emri dhe mbiemri i kandidatit theksohen në listën e kandidatëve sipas drejtshkrimit serb dhe me alfabetin cirilik, por mund të theksohen edhe sipas drejtshkrimit dhe alfabetit të pakicës kombëtare me ç'rast renditjen e cakton propozuesi.

Bartësin e listës së kandidatëve dhe renditjen e kandidatëve e cakton propozuesi.

Në listën e kandidatëve midis çdo tre kandidatëve sipas renditjes në listë (tri vendet e para, tri vendet e dyta dhe kështu deri në fund të listës) duhet të jetë së paku një kandidat – pjesëtar i asaj gjinie e cila është më pak e përfaqësuar në listë.

#### *Tërheqja e listës së kandidatëve*

### **Neni 73**

Propozuesi i listës së kandidatëve mund të tërheqë listën e kandidatëve jo më vonë se deri në ditën e përcaktimit të listës përmbledhëse të kandidatëve.

#### *Emërtimi i listës së kandidatëve*

### **Neni 74**

Lista e kandidatëve e ka emërtimin të cilin e përcakton propozuesi i listës së kandidatëve.

Nëse listën e kandidatëve e propozon grupi i zgjedhësve, emërtimi i listës së kandidatëve përmban emërtimin e përcaktuar me marrëveshje për formimin e grupit të zgjedhësve. Në emërtim të listës së kandidatëve mund të jetë emri dhe mbiemri i personit të cilin grupi i zgjedhësve e cakton si bartës të listës së kandidatëve. Emërtimi i listës së kandidatëve i grupit të zgjedhësve nuk mund të përmbajë fjalët "shoqatë" dhe "partia" në asnjë rasë, as emërtimin e shoqatës së regjistruar ose të partisë politike të regjistruar.

Nëse listën e kandidatëve e propozon shoqata, emërtimi i listës së kandidatëve mund të përmbajë emërtimin e shoqatës, që shënohet sipas emërtimit të shoqatës nga akti për regjistrim të saj. Në emërtim të listës së kandidatëve mund të jetë edhe emri dhe mbiemri i personit të cilin e cakton shoqata si bartës të listës së kandidatëve.

Nëse listën e kandidatëve e propozon partia politike e pakicës kombëtare, emërtimi i listës së kandidatëve duhet të përmbajë emërtimin e partisë politike nga akti për regjistrim të saj. Në emërtim të listës së kandidatëve mund të jetë edhe emri dhe mbiemri i personit të cilin partia politike e pakicës kombëtare e cakton si bartës të listës së kandidatëve.

Emërtimi i listës së kandidatëve të cilin e propozon grupi i zgjedhësve ose shoqata nuk mund të emërtohet me emërtim të kishës ose të bashkësisë fetare.

Emërtimi i listës së kandidatëve shënohet në gjuhën serbe dhe në alfabetin cirilik, por mund të shkruhet edhe në gjuhën dhe me alfabetin e pakicës kombëtare.

## **Neni 75**

*(Është hequr)*

*Paraqitja e listës së kandidatëve*

## **Neni 76**

Lista e kandidatëve i paraqitet Komisionit jo më vonë se 15 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.

Bashkë me listë të kandidatëve, Komisionit i paraqitet:

- 1) deklarata e vërtetuar e kandidatit se e pranon kandidaturën për anëtar të këshillit kombëtar;
- 2) pëlqimi i bartësit të listës së kandidatëve (nëse është caktuar) të jetë bartës i listës së kandidatëve;
- 3) autorizimi i personit të cilin propozuesi e ka autorizuar ta paraqesë listën e kandidatëve;
- 4) deklaratat e vërtetuara të votuesve se e mbështesin listën e kandidatëve;
- 5) lista e votuesve të cilët e mbështesin listën e kandidatëve, e hartuar me shkrim dhe në formë elektronike (cd ose dvd), kështu që lista në të dy format të jetë e njëjtë, e të cilën e nënshkruan personi i cili e paraqet listën e kandidatëve;
- 6) marrëveshja e vërtetuar për formimin e grupit të zgjedhësve, nëse listën e kandidatëve e propozon grupi i zgjedhësve;
- 7) kopja e vërtetuar e statutit të shoqatës, nëse listën e zgjedhësve e propozon shoqata.

*Shpallja e listës së kandidatëve*

## **Neni 77**

Komisioni e shpall listën e kandidatëve menjëherë sapo që e merr listën e kandidatëve dhe dokumentacionin shoqërues, por jo më vonë se 24 orë nga marrja e listës së kandidatëve.

Aktvendimin për shpalljen e listës së kandidatëve nga paragrafi 1, i këtij neni Komisioni ia dërgon propozuesit menjëherë.

### *Mangësitë e listës së kandidatëve*

#### **Neni 78**

Kur Komisioni konstaton që lista e kandidatëve nuk është paraqitur me kohë, e merr aktvendimin për refuzimin e listës së kandidatëve.

Kur Komisioni konstaton se lista e kandidatëve përmban mangësi të cilat e pengojnë shpalljen e listës së kandidatëve, brenda afatit prej 24 orësh nga marrja e listës së kandidatëve do ta marrë përfundimin me të cilin e urdhëron propozuesin e listës së kandidatëve që, brenda afatit prej 48 orësh nga momenti i dorëzimit të përfundimt të mënjanojë këto mangësi. Në përfundim propozuesit të listës së kandidatëve i tregohet mënyra se si të mënjanojë mangësitë.

Kur Komisioni konstaton se lista e kandidatëve përmban mangësi, përkatësisht kur konstaton se mangësitë nuk janë mënjeluar, ose nuk janë mënjeluar brenda afatit të përcaktuar, do ta marrë vendimin gjatë 48 orëve për refuzimin e shpalljes së listës së kandidatëve.

### *Lista shumemërore e zgjedhjeve*

#### **Neni 79**

Listën shumemërore të zgjedhjeve e përcakton Komisioni, për secilën pakicë kombëtare veçanërisht, dhjetë ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.

Lista shumemërore e zgjedhjeve i përmban të gjitha listat e kandidatëve për secilën pakicë kombëtare, me emrat personalë të të gjithë kandidatëve dhe me të dhënat për vitin e lindjes, profesionin dhe vendbanimin.



Renditja e listave të kandidatëve në listën shumemërore të kandidatëve përcaktohet sipas renditjes së shpalljes së listës së kandidatëve.

Listën shumemërore të zgjedhjeve për secilën pakicës kombëtare Komisioni e shpall në "Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë".

Propozuesi i listës së kandidatëve ka të drejtë që, brenda afatit prej 48 orësh nga dita e shpalljes së listës shumemërore të zgjedhjeve ta bëjë, përmes personit të cilin e autorizon, këqyrjen e dokumentacionit i cili është paraqitur bashkë me listat e shpallura të kandidatëve.

Komisioni nuk e përcakton listën shumemërore të zgjedhjeve nëse numri i kandidatëve sipas listave të shpallura të kandidatëve është më i vogël se numri i anëtarëve të këshillit kombëtar i cili zgjedhet.

### **Neni 80**

Ministria me aktvendim e mbyll listën e veçantë të zgjedhjeve 15 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.

Me aktvendim për mbylljen e listës së veçantë të zgjedhjeve përcaktohet numri i përgjithshëm i zgjedhësve për secilën pakicë kombëtare, si edhe numri i votuesve sipas qendrave të votimit, dhe këtë gjithsej për secilën qendër të votimit dhe të sistemuar sipas pakicave kombëtare.

Ministria e shpall në "Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë" aktvendimin për mbylljen e listës së veçantë të zgjedhjeve brenda afatit prej 24 orësh nga miratimi i aktvendimit dhe ia dërgon Komisionit.

Aktvendimi i Ministrisë është definitiv dhe kundër tij mund të fillojë kontesti administrativ brenda afatit prej 24 orësh nga shpallja e aktvendimit.

Gjykata kushtetuese ka për detyrë që për padinë të vendosë brenda afatit prej 48 orësh nga marrja e padisë.

Ministria i harton kopjet e vërtetuara nga lista e veçantë e zgjedhjeve për secilën qendër të votimit dhe ia dërgon Komisionit brenda afatit prej 48 orësh nga mbyllja e listës së veçantë të zgjedhjeve.

Kopja nga lista e veçantë e zgjedhjeve, përveç të dhënave nga neni 50 i këtij ligji, e përmban emërtimin e organit i cili e ka hartuar, datën e hartimit dhe shenjëën e qendrës së votimit për të cilën është bërë kopja.

Ministria ia dërgon Komisionit të gjitha aktvendimet për regjistrimet, shlyerjet, ndryshimet, plotësimet dhe korrigjimet në listën e veçantë të zgjedhjeve të cilat i ka sjellë nga mbyllja e qendrës së votimit deri 72 orë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

Komisioni i merr parasysh vetëm ato zgjidhje të Ministrisë të cilat i ka marrë jo më vonë se 48 orë para ditës së zgjedhjeve dhe në bazë të tyre i shënon ndryshimet në kopjet nga lista e veçantë e zgjedhjeve e pastaj i konfirmon edhe në "Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë" e shpall numrin përfundimtar të zgjedhësve për secilën pakicë kombëtare, si edhe numrin e zgjedhësve sipas qendrave të votimit, dhe këtë numrin e përgjithshëm për secilën qendër të votimit dhe të sistemuar sipas pakicave kombëtare.

### **Neni 81**

Organet republikane, organet e krahinës autonome, organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, institucionet publike dhe organet e tjera kanë për detyrë që, me kërkesë të zgjedhësve, menjëherë të lëshojnë dokumente publike të rëndësishme për realizimin e të drejtës elektorale, jo më vonë se ditën e nesërme nga dita e paraqitjes së kërkesës.

### **Neni 82**

Ministria dhe organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë që përfaqësuesve të autorizuar të paraqitësve të listave të konfirmuara të kandidatëve t'ia mundësojnë këqyrjen e listës së veçantë të zgjedhjeve, si edhe këqyrjen e dokumentacionit zyrtar në bazë të së cilit organi kompetent për mbajtjen e listës së

veçantë të zgjedhjeve e bën regjistrimin, shlyerjen, ndryshimet, plotësimet ose korrigjimet e listës së votimit.

Këqyrja bëhet në ambientet zyrtare të organit të cili gjendet dokumentacioni zyrtar.

### **Neni 83**

*(Është hequr)*

### **Zbatimi i zgjedhjeve**

*Votimi*

### **Neni 84**

Zgjedhësi voton në qendër të votimit në të cilën është regjistruar në kopjen e listës së veçantë të zgjedhjeve.

Jashtëzakonisht, zgjedhësi mund të votojë edhe jashtë qendrës së votimit nga paragrafi 1, i këtij neni sipas mënyrës së përcaktuar me Ligjin për zgjedhjen e deputetëve të popullit.

Mënyra e votimit jashtë qendrës së votimit dhe numri i zgjedhësve të cilët kanë votuar në këtë mënyrë, shënohet në procesverbalin për punën e këshillit të zgjedhjeve.

*Njohtimi i zgjedhësve për votim*

### **Neni 85**

Secilit zgjedhësi patjetër, jo më vonë se pesë ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve, i dërgohet njohtimi për ditën dhe kohën e mbajtjes së zgjedhjeve, me numrin dhe adresën e qendrës së votimit në të cilën votohet dhe me numrin nën të cilin është regjistruar në kopje të listës së veçantë të zgjedhjeve.

Njohtimin nga paragrafi 1, i këtij neni zgjedhësve ua dërgon organi kompetent për mbajtjen e listës së votimit.

*Mënyra e votimit*

## **Neni 86**

Zgjedhësi voton personalisht.

Zgjedhësi gjatë mbajtjes së zgjedhjeve mund të votojë vetëm një herë.

Votimi është i fshehtë.

Votohet në fletëvotimet e vulosura.

Në qendër të votimit dhe në 50 metra nga qendra e votimit është e ndaluar të theksohet çdo material propagandues.

Nëse gjatë votimit shkelen rregullat nga paragrafi 1 deri 4 të këtij neni, këshilli i zgjedhjeve shpërndahet, kurse votimi në atë qendër të votimit përsëritet.

Në qendër të votimit është e ndaluar të përdoren celularët dhe mjetet e tjera të ndërlidhjes dhe të komunikimit.

Udhëzimet më të hollësishme për masat me të cilat sigurohet fshehtësia e votimit i përcakton Komisioni.

*Koha e votimit në qendër të votimit*

## **Neni 87**

Qendrat e votimit hapen në orën 7,00, dhe mbyllen në orën 20,00. Gjatë kësaj kohe qendra e votimit vazhdimisht duhet të jetë e hapur.

Votuesve të cilët janë gjetur në qendër të votimit në momentin e mbylljes u mundësohet të votojnë.

Gjatë kohës së votimit anëtarët e Këshillit të zgjedhjeve ose zëvendësit e tyre duhet të jenë në qendër të votimit.

*Mbajtja e rendit në qendër të votimit*

## **Neni 88**

Nëse në qendër të votimit prishet rendi, këshilli i zgjedhjeve mund të ndërprejë votimin derisa nuk vendoset rendi. Shkaqet dhe kohëzgjatja e ndërprerjes së votimit shënohen në proceverbal për punën e këshillit të zgjedhjeve.

Nëse votimi është ndërprerë më gjatë se një orë, vazhohet për atë kohë sa ka zgjatur ndërprerja.

Në hapësirat në të cilat bëhet votimi mund të jenë të pranishëm numri i atë zgjedhësve sa ka vende të siguruar për fshehtësinë e votimit.

Ndalohet ndalja në qendër të votimit e personave të cilët, në pajtim me këtë ligj, nuk kanë të drejta dhe obligime lidhur me zbatimin e zgjedhjeve.

Pjesëtarët e policisë në detyrë mund të hyjnë në qendër të votimit vetëm nëse në qendër të votimit është prishur rendi dhe qetësia, me ftesën e kryetarit të Këshillit të zgjedhjeve.

Për shkak të shkeljes së dispozitave të paragrafit 1 deri 5 të këtij neni mund t'i paraqitet kundërshtimi Komisionit, i cili vendos a do të përsëritet votimi në atë vendvotim.

## **Materiali për zgjedhje**

### *Gjuha dhe alfabeti i materialit për zgjedhje*

#### **Neni 89**

Tërë materiali i zgjedhjeve dhe dokumentacioni shtypen në dy gjuhë, në gjuhën serbe dhe me alfabet cirilik dhe në gjuhë dhe në alfabet të pakicës kombëtare këshilli kombëtar i së cilës zgjedhet, nëse gjuha dhe alfabeti i saj janë në përdorim zyrtar në më së paku një njësi të qeverisjes vendore.

### *Fleta e votimit*

#### **Neni 90**

Fleta e votimit përmban:

- 1) numrin rendor para emërimit të listës së kandidatëve;
- 2) emërimet e listave të kandidatëve, sipas renditjes së përcaktuar në listën shumëmemërore të zgjedhjeve, me emër personal të kandidatit të parë në listë të kandidatëve;
- 3) vërejtja se votohet vetëm për një listë të kandidatëve, duke e rrumbullakësuar numrin rendor para emërimit të kësaj liste.

Fletat e votimit i përgatit dhe i vërteton Komisioni.

Komisioni e përcakton numrin e fletave të votimit, i cili duhet të jetë i barabartë me numrin e zgjedhësve të regjistruar në listë të veçantë të zgjedhjeve.

Fletat e votimit shtypen në një vend, në letër të mbrojtur me shenjë ujore.

Propozuesi i listës së kandidatëve ia dërgon Komisionit emrin e personit i cili ka të drejtë të marrë pjesë gjatë shtypjes, numërimit, paketimit të fletëvotimeve dhe dërgimit të tyre organeve kompetente për zbatimin e zgjedhjeve.

Komisioni më hollësisht e përcakton formën dhe pamjen e fletave të votimit, mënyrën dhe kontrollin e shtypjes së tyre dhe dërgimin dhe veprimin me fleta të votimit.

Komisioni ka për detyrë që për çdo këshill të zgjedhjeve me kohë ta përgatisë materialin për votim, e sidomos numrin e nevojshëm të fletave të votimit, listën shumëmemërore të zgjedhjeve, kopjen nga lista e veçantë e zgjedhjeve dhe formularin e procesverbalit për punën e këshillit të zgjedhjeve.

Dorëzimi i materialit për zgjedhje bëhet jo më vonë se 48 orë para mbajtjes së zgjedhjeve.

Drejtorja e njësisë së vetëqeverisjes vendore, kujdeset për rregullimin e qendrave të votimit dhe përgatitjen për secilin këshill të zgjedhjeve numrin e nevojshëm të kutive të votimit me pajisjen për vulosjen e tyre dhe me pajisjen për shkrim.

Në ditën e votimit, para fillimit të votimit, këshilli i zgjedhjeve e përcakton a është materiali për zgjedhje për atë qendër të votimit i plotë dhe i rregullt, a është qendra e votimit e rregulluar sipas mënyrës me të cilën sigurohet votimi i fshehtë dhe a mund të fillojë votimi. Të dhënat e theksuara shënohen në procesverbal për punë.

Lista shumëmemërore e zgjedhjeve e secilës pakice kombëtare duhet gjatë kohës së votimit të jetë dukshëm e theksuar në vendvotim.

Përfaqësuesit e propozueve të listave të kandidatëve kanë të drejtë të këqyrin materialin e zgjedhjeve. Këqyrja bëhet në ambiente të Komisionit. Njohtimi me materialin e zgjedhjeve mund të bëhet brenda afatit prej pesë ditëve nga dita e votimit.

#### *Ruajtja e materialit të zgjedhjeve*

#### **Neni 91**

Materiali i zgjedhjeve ruhet jo më pak se katër vjet.

Komisioni e përcakton mënyrën e këqyrjes dhe të ruajtjes së materialit të zgjedhjeve.

#### *Votimi*

#### **Neni 92**

Këshilli i zgjedhjeve e verifikon kutinë e votimit në prani të zgjedhësit i cili i pari arrin në qendër të votimit. Me verifikim vërtetohet a është e rregullt kutia e votimit, a është e zbrazët dhe a është e përshtatshme të garantojë siguri dhe fshehtësinë e përmbajtjes së fletave të votimit. Rezultati i kontrollit shënohet në listë të kontrollit, të cilin e nënshkruajnë anëtarët e këshillit të zgjedhjeve dhe zgjedhësi i cili i pari ka arritur në qendër të votimit.

Në kuti të votimit hidhet lista e kontrollit, e pastaj ajo në prani të zgjedhësit të parë vulozet, gjë që shënohet në procesverbal për punën e këshillit të zgjedhjeve.

Pas hapjes së kutisë së votimit, së pari verifikohet a ekziston në të lista e kontrollit. Nëse në kuti të votimit nuk ka listë të kontrollit, këshilli i zgjedhjeve shpërndahet dhe emërohet këshill i ri, kurse votimi në atë qendër të votimit përsëritet.

Formularin e listës së kontrollit dhe mënyrën e vulosjes së kutisë së votimit e cakton Komisioni.

### *Rrjedha e votimit*

#### **Neni 93**

Zgjedhësi ia thotë këshillit të zgjedhjeve emrin e vet personal dhe e dorëzon njohtimin për votim, kurse me letërnjohtim ose me dokument tjetër e dëshmon identitetin e vet.

Zgjedhësi nuk mund të votojë pa paraqitjen e dëshmive për identitetin e vet. Kryetari ose anëtari i këshillit të zgjedhjeve, pasiqë e konstaton identitetin e zgjedhësit, e rrumbullakëson numrin rendor në të cilin është shënuar zgjedhësi në kopje të listës së veçantë të zgjedhjeve dhe ia shpjegon mënyrën e votimit.

Zgjedhësi e nënshkruan listën e votimit dhe e merr fletëvotimin.

Secilit zgjedhësi i cili e ka filluar votimin dhe e ka marrë materialin për votim, me spraj special i shënohet gishti tregues i dorës së djathtë, si shenjë se tashmë ka votuar. Shenja në gisht tregues zgjat më së paku 24 orë.

Anëtarët e këshillit të zgjedhjeve nuk mundën në asnjë mënyrë të ndikojnë në vendimin e zgjedhësit.

Anëtarët e këshillit të zgjedhjeve kanë për detyrë që zgjedhësit, me kërkesë të tij, t'ia shpjegojnë mënyrën e votimit.

Anëtarët e këshillit të zgjedhjeve kanë për detyrë që sidomos të kenë kujdes që askush të mos e pengojë zgjedhësin me rastin e plotësimit të fletës së votimit dhe që plotësisht të sigurohet siguria e votimit të fshehtë.



Në ditën e zgjedhjeve nuk mund të bëhen kurrfarë ndryshimesh në kopjet nga listat e veçanta të votimit.

Nëse gjatë votimit shkelen dispozitat e paragrafëve 5 deri 9 të këtij neni, Komisioni e shpërndan këshillin e zgjedhjeve, e formon këshillin e ri të zgjedhjeve dhe e cakton përsëritjen e votimit në atë qendër të votimit.

#### *Mënyra e votimit*

### **Neni 94**

Zgjedhësi mund të votojë vetëm për një listë të kandidatëve. Votohet duke e rrumbullakësuar numrin rendor para emërimit të listës së kandidatëve për të cilën voton.

Zgjedhësi vet e palos fletëvotimin që të mos shihet si ka votuar dhe e hedh në kuti të votimit, e pastaj largohet nga qendra e votimit.

Në votim jashtë qendrës së votimit konform aplikohen rregullat për zgjedhjen e deputetëve të popullit.

### **Përcaktimi i rezultateve të zgjedhjeve**

#### *Përcaktimi i rezultateve të zgjedhjeve në qendër të votimit*

### **Neni 95**

Pas votimit të përfunduar, këshilli i zgjedhjeve e fillon konstatimin e rezultateve të votimit në qendër të votimit.

Këshilli i zgjedhjeve e përcakton numrin e fletëvotimeve të papërdorura , i hedh në mbështjellje të veçantë e vulos dhe numrin e shënon në procesverbal.

Në bazë të kopjes nga lista e veçantë e zgjedhjeve, këshilli i zgjedhjeve e përcakton numrin e përgjithshëm të zgjedhësve të cilët kanë votuar.

Kur hapet kutia e votimit, pas verifikimit të listës së kontrollit, fletëvotimet e vlefshme ndahen nga ato të pavlefshme dhe numri i fletëvotimeve të pavlefshme shënohet në procesverbal.

Fletë e votimit të pavlefshëm është fletëvotimi i paplotësuar, fletëvotimi i cili është plotësuar ashtu që nuk mund të konstatohet për cilën listë të kandidatëve ka votuar dhe fletëvotimi në të cilin janë rrumbullakësuar më shumë se një listë e kandidatëve.

Nëse në fletëvotim është rrumbullakësuar emri dhe mbiemri i kandidatit të parë në listë të kandidatëve ose është rrumbullakësuar emërtimi ose pjesa e emërtimit të listës së kandidatëve, përkatësisht , nëse njëkohësisht janë rrumbullakësuar numri rendor dhe emërtimi i listës së kandidatëve dhe emri dhe mbiemri i kandidatit të parë, një listë e tillë e kandidatëve konsiderohet e vlefshme.

Nëse konstatohet se numri i fletëvotimeve në kuti të votimit është më i madh se sa numri i zgjedhësve të cilët kanë votuar, këshilli i zgjedhjeve shpërndahet dhe emërohet këshilli i ri, kurse votimi në atë vendvotim përsëritet.

Pas konstatimit të rezultateve të votimit, këshilli i zgjedhjeve në procesverbal për punën e vet e shënon: numrin e fletëve të votimit të cilat i ka marrë, numrin e fletëve të papërdorura të votimit, numrin e fletëve të pavlefshme të votimit, numrin e fletëve të vlefshme të votimit, numrin e votave të dhëna për secilën listë të kandidatëve, numrin e zgjedhësve sipas kopjes nga lista e votimit dhe numrin e zgjedhësve të cilët kanë votuar.

Në procesverbal për punën e këshillit të zgjedhjeve shënohen edhe vërejtjet dhe mendimet e anëtarëve të këshillit të zgjedhjeve, propozuesit të listave të kandidatëve, si edhe të gjitha faktet tjera me rëndësi për votim.

Procesverbalin për punën e këshillit të zgjedhjeve e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e këshillit të zgjedhjeve.

*Procesverbali për punën e këshillit të zgjedhjeve*

**Neni 96**

Procesverbali për punën e këshillit të zgjedhjeve hartohet në formular të përcaktuar i cili shtypet në gjashtë ekzemplarë.

Ekzemplari i parë i procesverbalit me materialin për zgjedhje i dërgohet Komisionit.

Ekzemplari i dytë i procesverbalit theksohet në qendër të votimit që publikisht të shihet.

Katër ekzemplarët e tjerë u dorëzohen përfaqësuesve të propozuesit të listës së kandidatëve të cilët e kanë fituar numrin më të madh të votave në këtë qendër të votimit dhe këtë menjëherë nëse propozuesi i listës së kandidatëve e ka përfaqësuesin në këshill të zgjedhjeve, e nëse nuk e ka, përfaqësuesi i propozuesit të listës së kandidatëve mund ta marrë ekzemplarin e procesverbalit nga Komisioni brenda afatit prej 12 orësh nga përfundimi i votimit.

Propozuesit e tjerë të listave të kandidatëve kanë të drejtë që, brenda afatit prej 12 orësh nga dërgimi i materialit nga qendra e votimit Komisionit, nga Komisioni të marrin fotokopjen e vërtetuar të procesverbalit nga qendra e votimit.

#### *Dërgimi i rezultateve të votimit nga qendra e votimit*

### **Neni 97**

Pas përcaktimit të rezultatit të votimit, këshilli i zgjedhjeve menjëherë, e më së voni brenda afatit prej 12 orësh nga data e mbylljes së qendrës së votimit, ia dërgon Komisionit: procesverbalin për punë; fotokopjen nga lista e veçantë e zgjedhjeve ; në zarfa të veçantë të vulosur fletëvotimet e papërdorura, të pavlefshme dhe të vlefshme, si edhe materialin e mbetur të zgjedhjeve.

#### *Përcaktimi dhe publikimi i rezultateve të zgjedhjeve*

### **Neni 97a**

Në bazë të procesverbalit për punën e këshillave të zgjedhjeve, Komisioni i përcakton rezultatet e përgjithshme për secilin këshill kombëtar , dhe këtë:

1) numrin e zgjedhësve të regjistruar në listë të veçantë të zgjedhjeve;

- 2) numrin e qendrave të votimit në të cilat është votuar;
- 3) numrin e përgjithshëm të zgjedhësve të cilët kanë votuar;
- 4) numrin e fletëve të votimit që i ka marrë;
- 5) numrin e fletëve të papërdorura të votimit;
- 6) numrin e fletëve të përdorura të votimit;
- 7) numrin e fletëve të pavlefshme të votimit;
- 8) numrin e fletëve të vlefshme të votimit;
- 9) numrin e votave të cilat i kanë marrë listat e kandidatëve;
- 10) numri i mandatit në këshillin kombëtar të cilin e ka marrë secila nga listat e kandidatëve.

Raportin me rezultatet e përgjithshme të zgjedhjeve Komisioni e shpall në "Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë" brenda afatit prej 96 orësh nga ora e përfundimit të votimit.

Nga përfundimi i votimit deri me shpalljen e rezultatit në zgjedhje, Komisioni i shpall përmes mjeteve të informimit të dhënat e përkohshme për rezultatet e zgjedhjeve.

#### *Ndarja e mandateve sipas listave të kandidatëve*

### **Neni 98**

Secilës liste të kandidatëve i takon numri i mandateve në përpjesëtim me numrin e fituar të votave.

Komisioni i ndan mandatet me aplikimin e sistemit të herësit më të madh.

Mandatet ndahen ashtu që numri i përgjithshëm i votave të cilin e ka fituar secila listë e kandidatëve, ndahet me numrat nga një deri me përfundimisht numrin e anëtarëve të këshillit kombëtar i cili zgjedhet.

Herësit e fituar sistemohen sipas madhësisë, kurse merren parasysh aq herës më të mëdhenj sa anëtarë të këshillit nacional zgjedhen.

Nëse dy ose më shumë lista të kandidatëve i fitojnë herësit e njëjtë në bazë të të cilëve ndahet një mandat, e nuk ka më mandate të pandara, mandati i ndahet listës së kandidatëve e cila e ka marrë numrin më të madh të votave.

Kur listës së kandidatëve i takojnë më shumë mandate se sa që ka kandidatë në të për anëtarë të këshillit kombëtar, mandati i ndahet listës së kandidatëve e cila e ka këtë herës më të madh.

Mandatet të cilat i takojnë listës së kandidatëve u ndahen kandidatëve nga lista e kandidatëve sipas renditjes së tyre në listën e kandidatëve, duke filluar nga kandidati i parë.

Brenda tri ditësh nga përcaktimi i rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve Komisioni e merr aktvendimin për ndarjen e mandateve të anëtarëve të këshillit kombëtar.

Aktvendimi i dërgohet Ministrisë dhe shpallet në "Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë".

Kundër aktvendimit për ndarjen e mandateve anëtarët e këshillit kombëtar mund të fillojnë kontesti administrativ brenda afatit prej 24 orësh nga data e shpalljes së aktvendimit.

Gjykata kushtetuese ka për detyrë që për padinë të vendosë brenda afatit prej 48 orësh nga marrja e padisë.

Kandidatëve të cilëve u janë ndarë mandatet Komisioni ua lëshon vërtetimin se janë zgjedhur anëtar të këshillit kombëtar.

## **Neni 99**

*(Është hequr)*

### **3. Zgjedhja për anëtarë të këshillave kombëtare përmes kuvendit elektoral**

## **Neni 100**

Kuvendi elektoral i zgjedh anëtarët e këshillit kombëtar nëse nuk janë plotësuar kushtet për zgjedhje të drejtpërdrejta edhe pse pas shpërndarjes së këshillit kombëtar zgjedhjet e reja shpallen brenda afatit prej 60 ditësh nga shpërndarja.

Procedura e zgjedhjes së anëtarëve përmes kuvendit elektoral fillon me vendimin për shpalljen e zgjedhjeve.

Data dhe vendi i mbajtjes së kuvendit elektoral publikohet në mjetet e informimit publik, me ftesë publike të gjithë elektorëve që me kohë të paraqesin fletëregjistrimet e plota me shkrim për pjesëmarrje në kuvendin elektoral.

### **Neni 101**

Të drejtën që të jetë elektor e ka pjesëtari i pakicës kombëtare i regjistruar në listë të veçantë të zgjedhjeve kandidurën e të cilit me shkrim e mbështesin jo më pak se:

1) 20 pjesëtarë të pakicës kombëtare të regjistruar në listë të veçantë të zgjedhjeve, për pakicën kombëtare numri i së cilës sipas regjistrimit të fundit të popullsisë është më i vogël se 10.000 persona;

2) 30 pjesëtarë të pakicës kombëtare të regjistruar në listë të veçantë të zgjedhjeve, për pakicën kombëtare numri i së cilës sipas regjistrimit të fundit të popullsisë është më i madh se 10.000 persona, por më i vogël se 20.000 persona;

3) 45 pjesëtarë të pakicës kombëtare të regjistruar në listë të veçantë të zgjedhjeve, për pakicën kombëtare numri i së cilës sipas regjistrimit të fundit të popullsisë është më i madh se 20.000 persona, por më i vogël se 50.000 persona;

4) 60 pjesëtarë të pakicës kombëtare të regjistruar në listë të veçantë të zgjedhjeve, për pakicën kombëtare numri i së cilës sipas regjistrimit të fundit të popullsisë është më i madh se 50.000 persona, por më i vogël se 100.000 persona;

5) 100 pjesëtarë të pakicës kombëtare të regjistruar në listë të veçantë të zgjedhjeve, për pakicën kombëtare numri i së cilës sipas regjistrimit të fundit të popullsisë është më i madh se 100.000 persona.

Nënshkrimet për përkrahjen e elektorëve duhet të jenë të vërtetuar te organi kompetent për verifikimin e nënshkrimeve. Verifikimi i nënshkrimit nuk i nënshtrohet pagimit të taksës.

### **Neni 102**

Kandidati për elektor ia paraqet Ministrisë fletëregjistrimin elektorale për konfirmim.

Fletëregjistrimi elektorale përmban deklaratën se kandidati paraqitet për kuvend elektorale të pakicës kombëtare dhe të dhënat personale dhe deklaratat e vërtetuara të zgjedhësve se e mbështesin kandidaturën për elektor, si edhe listën e votuesve të cilët e mbështesin kandidaturën për elektor të hartuar në formën me shkrim dhe elektronike (cd ose dvd), kështu që lista në të dy format duhet të jetë e njëjtë, e të cilën e nënshkruan personi i cili e paraqet fletëregjistrimin elektorale për konfirmim.

Pjesëtari i pakicës kombëtare mund të mbështesë vetëm një elektor.

Formën dhe përmbajtjen e formularit për grumbullimin e nënshkrimeve të zgjedhësve të cilët i mbështesin elektorët e përcakton ministri.

Fletëparaqitja e elektorit i paraqitet Ministrisë jo më vonë se 30 ditë para kuvendit elektorale.

Ministria me aktvendim vendos për konfirmimin e fletëregjistrimit elektorale brenda afatit prej 48 orësh nga marrja e fletëregjistrimit elektorale.

Aktvendimi i Ministrisë është definitiv dhe kundër tij mund të fillojë kontesti administrativ brenda afatit prej 24 orësh nga marrja e aktvendimit, kurse Gjykata administrative vendos për padinë brenda afatit prej 48 orësh.

Ministria ua dërgon ftesën me shkrim në kuvendin elektor të gjithë elektorëve fletëregjistrimi i të cilëve është konfirmuar.

### **Neni 103 dhe 104**

*(Janë hequr)*

### **Neni 105**

Kuvendi elektoral mund të mbahet nëse është e pranishme më shumë se gjysma e elektorëve fletëregjistrimet e të cilëve janë konfirmuar.

Jashtëzakonisht nga paragrafi 1 i këtij neni, kuvendi elektoral nuk mbahet nëse për kuvend elektoral nuk do të konfirmohet ose nëse në kuvend elektoral nuk marrin pjesë:

1) jo më pak se 20 elektorë të pakicave kombëtare numri i të cilave sipas regjistrimit të fundit të popullsisë është më i vogël se 10.000 persona;

2) jo më pak se 30 elektorë të pakicave kombëtare numri i të cilave sipas regjistrimit të fundit të popullsisë është më i madh se 10.000 persona, por më i vogël se 20.000 persona;

3) jo më pak se 45 elektorë të pakicave kombëtare numri i të cilave sipas regjistrimit të fundit të popullsisë është më i madh se 20.000 persona, por më i vogël se 50.000 persona;

4) jo më pak se 60 elektorë të pakicave kombëtare numri i të cilave sipas regjistrimit të fundit të popullsisë është më i madh se 50.000 persona, por më i vogël se 100.000 persona;

5) jo më pak se 100 elektorë të pakicave kombëtare numri i të cilave sipas regjistrimit të fundit të popullsisë është më i madh se 100.000 persona.

### **Neni 106**

Zgjedhjet në kuvendin elektoral i zbaton këshilli prej tre anëtarësh (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli), të cilin e emëron Komisioni në mesin e atyre që i njohin procedurat e zgjedhjeve.

Komisioni e emëron Këshillin brenda tri ditësh qëkur nga Ministria e merr njohtimin për këtë se për kuvend elektoral është konfirmuar numri i mjaftueshëm i elektorëve i përcaktuar me këtë ligj.

Këshilli e miraton edhe aktvendimin për ndërprerjen e zgjedhjeve për këshill kombëtar nëse në kuvend elektoral nuk merr pjesë numri më i vogël i elektorëve i



përcaktuar me këtë ligj, nëse për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit kombëtar nuk paraqitet asnjë listë e kandidatëve, nëse asnjë listë e paraqitur e kandidatëve nuk shpallet dhe nëse me këtë ligj për shkaqe të përcaktuara nuk konfirmohet lista shumemërore e zgjedhjeve.

Kundër secilit aktvendimi të Këshillit elektor mund t'i paraqesë ankesë Komisionit brenda afatit prej tri ditësh nga marrja e aktvendimit.

Komisioni vendos për ankesën brenda afatit prej 12 orësh nga marrja e ankesës.

Kundër aktvendimit të Komisionit mund të paraqitet padia Gjykatës administrative brenda afatit prej tri orësh nga marrja e aktvendimit, kurse Gjykata administrative vendos për padinë brenda afatit prej 12 orëve.

Anëtarët e Këshillit kanë të drejtë për kompensim për punë në Këshill, të cilin e përcakton Komisioni.

#### **Neni 107**

Kuvendi elektor fillon punën e vet ashtu që Këshilli e konfirmon numrin e elektorëve të pranishëm, bashkë me ndihmën e listës së elektorëve fletëregjistrimi elektor i të cilëve është konfirmuar të cilin e dërgon Ministria.

#### **Neni 108**

Kuvendi elektor vendos publikisht, me shumicën e votave të elektorëve të pranishëm.

Për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit kombëtar, kuvendi i elektorëve vendos me votim të fshehtë.

Kuvendi elektor mund të vendosë me votim të fshehtë edhe për çështjet e tjera, nëse vendos kështu.

#### **Zbatimi i zgjedhjeve**

#### **Neni 109**

Kuvendi elektoral i zgjedh anëtarët e këshillit kombëtar nga radha e zgjedhësve të regjistruar në listë të veçantë të votuesve.

Kuvendi elektoral i zgjedh anëtarët e këshillit kombëtar sipas sistemit proporcional.

Listën e kandidatëve (në tekstin e mëtejshëm: lista) për anëtarë të këshillit kombëtar mund ta propozojë një e katërta e elektorëve të pranishëm.

Bashkë me listë të kandidatëve bashkëlidhet edhe deklarata e vërtetuar e zgjedhësit për pranimin e kandidaturës.

Në listë midis çdo tre kandidatëve sipas renditjes në listë (tri vendet e para, tri vendet e dyta dhe kështu deri në fund të listës) duhet të jetë jo më pak se nga një kandidat – pjesëtar i asaj gjinie e cila është më pak e përfaqësuar në listë.

Elektori mundet me votë të vet të mbëshesë vetëm një listë.

Në listë duhet të gjendet jo më pak se një e treta e kandidatëve nga numri i anëtarëve të këshillit kombëtar i cili zgjedhet, dhe më së shumti aq kandidat sa anëtarë të këshillit kombëtar zgjedhen. Renditjen e kandidatëve e cakton propozuesi i listës.

Elektorët votojnë fshehtëzi, në fletëvotimet e përgatitura më parë, në të cilat e shënojnë emrin e bartësit, përkatësisht numrin e listës.

Këshilli i ndan mandet me aplikimin e sistemit të herësit më të madh.

Mandatet ndahen ashtu që numri i përgjithshëm i votave të cilin e ka marrë secila listë, ndahet me numrin nga një deri përfundimisht me numrin e anëtarëve të këshillit kombëtar i cili zgjedhet.

Herësit e fituar sistemohen sipas madhësisë, kurse merret parasysh aq herës më të mëdhenj, sa anëtarë të këshillit kombëtar zgjedhen.

Nëse dy ose më shumë lista i fitojnë herësit e njëjtë në bazë të të cilëve ndahet një mandat, e nuk ka më mandate të pandara, mandati do të ndahet në listën e cila e ka fituar numrin më të madh të votave.

Kur listës i takojnë më shumë mandate se sa që janë kandidatë në të për anëtarë të këshillit kombëtar, mandati i jepet listës e cila e ka herësin vijues më të madh.

Mandatet të cilat i takojnë listës u ndahen kandidatëve nga lista sipas renditjes së tyre në listë, duke filluar nga kandidati i parë.

Brenda afatit prej tri ditësh nga konfirmimi i rezultateve të para përfundimtare Këshilli e miraton aktvendimin për ndarjen e mandateve të anëtarëve të këshillave kombëtare dhe ia dërgon Ministrisë dhe e shpall në "Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë".

Kandidatëve të cilëve u janë ndarë mandatat Këshilli ua lëshon vërtetimin se janë zgjedhur anëtar të këshillit kombëtar.

## Vla SEANCA KONSTITUTIVE E KËSHILLIT KOMBËTAR

### **Neni 109a**

Seancën konstitutive të këshillit kombëtar e fton ministri, kështu që ajo mbahet brenda afatit prej 20 ditësh nga konfirmimi i rezultateve përfundimtare në zgjedhje.

Në seancën konstitutive konfirmohet mandati i anëtarëve të këshillit kombëtar.

Konfirmimi i mandatit të anëtarit të këshillit kombëtar bëhet në bazë të vërtetimit për zgjedhjen për anëtar të këshillit kombëtar dhe aktvendimit për ndarjen e mandateve të të anëtarëve të këshillit kombëtar.

Këshilli kombëtar është konstituuar me konfirmimin e mandateve të të gjithë anëtarëve të këshillit kombëtar.

Puna e seancës konstitutive e legjislaturës së parë rregullohet me Rregullore të përkohshme të punës të cilën e miraton Ministria. Në mungesë të rregullave të veta, rregulloren e përkohshme të punës e aplikojnë edhe këshillat e tjera kombëtare.

### **Neni 110 dhe 111**

*(Janë hequr)*

## VII FINANCIMI I VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT KOMBËTAR

### Neni 112

Këshilli kombëtar e miraton planin e vet vjetor financiar, raportin financiar dhe llogarinë përfundimtare.

Në plan vjetor financiar të këshillit kombëtar pasqyrohen të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e këshillit kombëtar për vitin kalendarik.

Plani vjetor financiar miratohet sipas procedurës dhe sipas mënyrës së parashikuar me statut të këshillit kombëtar.

Këshilli kombëtar, brenda afatit prej 15 ditësh nga data e miratimit të raportit financiar ose llogarisë përfundimtare, ekzemplarën e raportit ose llogarinë ia dërgon Ministrisë.

### Përdorimi i mjeteve

### Neni 113

Mjetet e fituara, në pajtim me këtë ligj, mund të përdoren për financimin e shpenzimeve për:

- 1) veprimtarinë e rregullt të këshillit kombëtar;
- 2) financimin e punës së institucioneve, fondacioneve, shoqërive ekonomike dhe organizatave themelues ose bashkëthemelues i të cilave është këshilli kombëtar, institucioni, fondacioni, shoqëritë ekonomike dhe organizatat e tjera të drejtat themelore të të cilave pjesërisht ose në tërësi kanë kaluar në këshill kombëtar.

Në shpenzime të veprimtarisë së rregullt të këshillit kombëtar hyjnë sidomos:

- 1) financimi ose bashkëfinancimi i programit dhe i projekteve në fushën e arsimit, kulturës, informimit dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit të pakicës kombëtare;
- 2) shpenzimet për marrjen me qira dhe përdorimin e ambienteve të këshillit kombëtar;

- 3) fitimet, tatimet dhe kontributet e të punësuarëve në këshill kombëtar;
- 4) honoraret dhe kontributet për punë të kryer për nevoja të këshillit kombëtar;
- 5) shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjet për udhëtime zyrtare;
- 6) blerja e materialit për zyra dhe pajisja për punë të këshillit kombëtar.

### **Llojet e mjeteve**

#### **Neni 114**

Mjetet për financimin e punës së këshillave kombëtare sigurohen nga buxheti i Republikës së Serbisë, buxheti i krahinës autonome dhe buxheti i njësisë së vetëqeverisjes vendore, nga donacionet dhe nga të ardhurat e tjera.

#### **Neni 115**

Shuma e mjeteve nga burimet publike të cilat sigurohen për financim të veprimtarive të këshillave kombëtare përcaktohet për çdo vit me Ligjin për buxhetin e Republikës së Serbisë, përkatësisht me vendimet për buxhetin e KA të Vojvodinës dhe njësisë vetëqeverisëse vendore.

Mjetet nga paragrafi 1, i këtij neni të cilat sigurohen në buxhetin e Republikës së Serbisë ndahen që 30% u ndahen në shuma të njëjta të gjitha këshillave të regjistruara kombëtare në Republikën e Serbisë, kurse pjesa e mbetur (70%) përpjesëtimisht me numrin e pjesëtarëve të pakicës së caktuar kombëtare të cilën e përfaqëson këshilli kombëtar, si edhe me numrin e përgjithshëm të institucioneve të kësaj pakice kombëtare në fushën e kulturës, arsimit, informimit dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit dhe në bazë të aktiviteteve të këtyre institucioneve.

Vendimin për ndarjen e mjeteve nga buxheti i Republikës së Serbisë e miraton Ministria, duke i pasur parasysh propozimet e këshillave kombëtare.

Mjetet nga paragrafi 1, i këtij neni të cilat sigurohen në buxhetin e krahinës autonome ndahen, në pajtim me vendimin e organit kompetent të krahinës autonome, këshillave kombëtare të cilat e kanë selinë në territorin e krahinës autonome.

Mjetet nga paragrafi 1, i këtij neni të cilat sigurohen në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndahen, në pajtim me vendimin e organit kompetent të njësisë së vetëqeverisjes vendore, këshillave kombëtare të cilat i përfaqësojnë pakicat kombëtare të cilat në popullsinë e njësisë së vetëqeverisjes vendore e arrijnë jo më pak se 10% nga popullsia e përgjithshme ose e pakicave kombëtare gjuha e të cilave është në përdorim zyrtar në zonën e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

### **Financimi i punës së institucioneve të drejtat themelore të të cilëve kanë kaluar në këshilla kombëtare**

#### **Neni 116**

Financimi i punës së institucioneve ose i organizatave të tjera të drejtat themelore të të cilave pjesërisht ose në tërësi, kanë kaluar në këshilla kombëtare kryhen nga të njëjtat burime dhe në bazë të normativave të njëjta nga të cilat këto institucione ose organizata janë financuar para kalimit të të drejtave themeluese në këshilla kombëtare.

Në kontratën për kalimin e të drejtave themelore në këshilla kombëtare rregullohen obligimet financiare të themeluesit të mëparshëm ndaj institucionit ose organizatë tjetër themelues i të cilës bëhet këshilli kombëtar.

Këshilli kombëtar mund të sigurojë mjete plotësuese për punë dhe veprimtari të institucioneve dhe të organizatave të tjera të drejtat themeluese të të cilit kanë kaluar në këshill kombëtar.

### **Llogaria e këshillit kombëtar, obligimet e mbajtjes së kontabilitetit dhe kontrolli financiar**

#### **Neni 117**

Këshilli kombëtar e ka llogarinë.

Këshilli kombëtar ka për detyrë të mbajë kontabilitetin për të gjitha të ardhurat adhe shpenzimet.

Kontabiliteti mbahet sipas origjinës, shumës dhe strukturës së ardhurave dhe shpenzimeve, në pajtim me dispozitat me të cilat rregullohet zyra e llogarive.

Evidencat e kontabilitetit për të ardhura dhe shpenzime të këshillit kombëtar janë objekt i rishikimit vjetor, në pajtim me dispozitat me të cilat rregullohet kontabiliteti, dhe mund të jenë objekt i kontrollit të organeve kompetente.

Këshilli kombëtar ka për detyrë të mbajë evidencë të veçantë për pronën e vet.

### **Personi përgjegjës**

#### **Neni 118**

Me statut të këshillit kombëtar përcaktohet personi përgjegjës për menaxhim financiar, paraqitjen e raporteve dhe mbajtjen e librave të këshillit kombëtar.

Nëse këshilli kombëtar me statut nuk e cakton personin përgjegjës, person përgjegjës do të konsiderohet kryetari i këshillit kombëtar.

### **Fondi i buxhetit për pakica kombëtare**

#### **Neni 119**

Këshillat kombëtare marrin pjesë në procedurën e ndarjes së mjeteve të fondit të buxhetit për pakica kombëtare, të cilat ndahen me konkurs publik për financimin e programit dhe të projekteve nga fusha e kulturës, arsimit, informimit dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit të pakicave kombëtare.

Fondin e buxhetit për pakica kombëtare e administron Ministria.

### **VIII MBIKËQYRJA**

#### **Neni 120**

Mbikëqyrjen e legjislacionit të punës dhe të akteve të këshillave kombëtare, në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin, e kryen Ministria.

Këshilli kombëtar ka për detyrë që ministrisë e cila e kryen mbikëqyrjen ndaj ligjshmërisë së punës dhe të akteve, me kërkesë të tij, brenda afatit prej tetë ditësh të dërgojë të dhënat, aktet dhe dokumentet e kërkuara.

Për dërgimin e të dhënave, akteve dhe dokumenteve të kërkuara përgjegjës është kryetari i këshillit kombëtar.

### **Neni 121**

Ministria kompetente do të fillojë procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë së statutit, dispozitave ose akteve të tjera të përgjithshme të këshillit kombëtar para Gjykatës kushtetuese, nëse konsideron se ky akt nuk është në pajtim me Kushtetutën, ligjin ose me dispozitat e tjera republikane.

Organi kompetent i krahinës autonome do të fillojë procedurën nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse konsideron se akti nuk është në pajtim me dispozitat krahinore.

### **Neni 122**

Ministria ka për detyrë të ndalojë nga ekzekutimi aktin e këshillit kombëtar për të cilin konsideron se nuk është në pajtim me Kushtetutën, ligjin ose me dispozitat e tjera, me aktvendim i cili shpallet në "Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë". Ministria e fillon procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë së aktit para Gjykatës kushtetuese, brenda afatit prej pesë ditësh nga dita e shpalljes së aktvendimit.

Nëse Ministria nuk e fillon procedurën nga paragrafi 1, i këtij neni, aktvendimi për ndaljen nga ekzekutimi pushon të vlejë.

## **IX DISPOZITAT NDËSHKIMORE**

### **Neni 123**

Me dënim me të holla nga 10.000 deri 30.000 dinarë do të dënohet për kundërvajtje personi i cili:



1) nuk e zbaton ose në kundërshtim me dispozitat e nenit 47 të këtij ligji e zbaton regjistrimin ose shlyerjen nga lista e veçantë e zgjedhjeve;

2) i përdor të dhënat nga lista e veçantë e zgjedhjeve e pjesëtarëve të pakicave kombëtare për qëllime për të cilat nuk është e lejueshme me këtë ligj, në kundërshtim me nenin 49 të këtij ligji.

#### **Neni 124**

Me dënim me të holla nga 10.000 deri 30.000 dinarë do të dënohet për kundërvajtje personi i cili në qendër të votimit e përdor pejxherin, celularin dhe mjetet e tjera të ndërlidhjes dhe komunikimit, në kundërshtim me nenin 86 paragrafi 7, i këtij ligji.

#### **Neni 125**

Me dënim me të holla nga 10.000 deri 30.000 dinarë do të dënohet për kundërvajtje personi i cili shkakton çrregullim në qendër të votimit, për shkak të të cilit votimi, në pajtim me nenin 88 të këtij ligji është dashur të ndërpritet.

#### **Neni 126**

Me dënim me të holla nga 10.000 deri 30.000 dinarë do të dënohet për kundërvajtje personi juridik ose fiziki i cili e çrregullon ose e keqpërdor të drejtën për shfrytëzimin e simboleve kombëtare.

#### **Neni 127**

Me dënim me të holla nga 500 deri 50.000 dinarë do të dënohet për kundërvajtje personi përgjegjës në këshillin kombëtar, nëse:

1) nuk vepron sipas nenit 6, paragrafi 3, i këtij ligji;

2) në kundërshtim me dispozitat e nenit 120, paragrafi 2, brenda afatit prej tetë ditësh nga dita e dërgimit të kërkesës, nuk ia dërgon Ministrisë e cila e bën mbikëqyrjen për ligjshmërinë e punës dhe të akteve të dhënat, aktet dhe dokumentet e kërkuara.

#### **Neni 128**

Me dënim me të holla nga 50.000 deri 200.000 dinarë do të dënohet për kundërvajtje këshilli kombëtar, nëse:

1) brenda afatit prej 30 ditësh nga miratimi i ndryshimeve dhe i plotësimeve të statutit, nuk e njohton për këtë Ministrinë dhe nuk i dërgon ndryshimet dhe plotësimet e statutit, si edhe procesverbalin nga seanca në të cilën janë aprovuar;

2) në kundërshtim me dispozitat e nenit 120, paragrafi 2, brenda afatit prej tetë ditësh nga dita e dërgimit të kërkesës, nuk ia dërgon ministrisë e cila e bën mbikëqyrjen e legjislacionit të punës dhe të akteve të këshillave kombëtare të dhënat, aktet dhe dokumentet e kërkuara.

## X DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

### **Neni 129**

Brenda afatit prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ministri e miraton vendimin për shpalljen e zgjedhjeve për këshilla kombëtare.

Nga data e shpalljes e deri në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve nga paragrafi 1, i këtij neni nuk mund të kalojnë më pak se 60 por as më shumë se 90 ditë.

Kuvendi elektorale do të mbahet brenda afatit i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 60 ditë, por as më i gjatë se 90 ditë nga data e miratimit të vendimit nga neni 100, paragrafi 2.

Mënyra e zbatimit të zgjedhjeve do të caktohet në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

### **Neni 130**

Këshillat kombëtare kanë për detyrë që, brenda afatit prej tre muajsh nga data e konstituimit të tyre, të miratojnë statutin e ri ose atë ekzistues dhe aktet e përgjithshme t'i harmonizojnë me dispozitat e këtij ligji.

### **Neni 131**

Dispozitat e këtij ligji të cilat kanë të bëjnë me të drejtën e dhënies së propozimeve ose mendimeve në procedurën e zgjedhjeve, përkatësisht emërimin e anëtarëve të

organeve të cilat i emëron Republika e Serbisë, krahina autonome ose njësia e vetëqeverisjes vendore, do të aplikohet nga procedura e parë e ardhshme për zgjedhje, përkatësisht emërimin e anëtarëve të këtyre organeve.

### **Neni 132**

Ministri përbërjen e përhershme të KQZ do të emërojë brenda afatit prej 30 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### **Neni 133**

Dispozitat nga neni 4, paragrafi 3, i nenit 52, paragrafi 3, i nenit 55, dhe neni 102, paragrafi 4, i këtij ligji, Ministria do ta miratojë brenda afatit prej 30 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### **Neni 134**

Këshilli ekzekutiv i Lidhjes së komunave hebreje të Serbisë i kryen funksionet e këshillit kombëtar, kurse kryetari i Lidhjes së komunave hebreje të Serbisë është anëtar i Këshillit të Republikës së Serbisë për pakica kombëtare.

### **Neni 135**

Nëse këshilli kombëtar nuk i përcakton emërtimet tradicionale nga neni 22 i këtij ligji brenda afatit prej tre muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, emërtimet tradicionale do t'i përcaktojë Qeveria, përkatësisht organi kompetent i krahinës autonome, e nëse këshilli kombëtar e ka selinë në territorin e krahinës autonome, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, organizatat e pakicave kombëtare dhe me ekspertët për gjuhë, histori dhe gjeografi të kësaj pakice kombëtare.

Dispozitat nga paragrafi 1 i këtij neni nuk ka të bëjnë me këshillat kombëtare të cilat emërtimet tradicionale nga neni 22 i këtij ligji i kanë konfirmuar dhe i kanë publikuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### **Neni 136**

Ministria mundet që për disa zgjedhje të lejojë që vendbanimin si kusht për përdorimin e të drejtës aktive ose pasive elektorale ta zëvendësojë me kushtin e vendqëndrimit nëse bëhet fjalë për persona me vendbanim në territorin e Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit.

### **Neni 137**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji bëhet zgjedhja e përgjithshme, përkatësisht rizgjedhja e të gjitha këshillave kombëtare.

Nëse ditën e shpalljes së zgjedhjeve për këshilla kombëtare, këshilli kombëtar nuk e ka mbushur gjysmën e mandatit, mandati i tij përsëritet dhe do të zgjasë aq sa zgjasin edhe mandatet e këshillave kombëtare të cilat zgjedhen.

Këshillat kombëtare të cilat janë zgjedhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji, e mandati i të cilave ka skaduar, vazhdojnë të punojnë derisa të zgjedhet, përkatësisht konstituohet këshilli kombëtar sipas dispozitave të këtij ligji.

### **Neni 138**

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji pushojnë të vlejshme:

1) Neni 24 i Ligjit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare ("Fletorja zyrtare e RFJ", numër 11/02);

2) Rregullorja për mënyrën e punës së kuvendit të elektorëve për zgjedhjen e këshillave të pakicave kombëtare ("Fletorja zyrtare e RFJ", numër 41/02).

### **Neni 139**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë".

***Nenet e pavarura të Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit për këshillat kombëtare të pakicave kombëtare ("Fl. zyrtare e RS", nr. 55/2014)***

## **Neni 67**

Dispozitat e këtij ligji për numrin e pjesëtarëve të moshë madhore të pakicës kombëtare të cilët duhet ta mbështesin kërkesën për formimin e listës së veçantë të zgjedhjeve aplikohen në pakica kombëtare për të cilat deri me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk e kanë formuar listën e veçantë të zgjedhjeve.

Ministri i shpall zgjedhjet për anëtarë të këshillit kombëtar në pajtim me këtë ligj kështu që ato do të mbahen në tetor të vitit 2014.

Këshillat kombëtare kanë për detyrë që pas mbajtjes së zgjedhjeve në pajtim me këtë ligj t'i harmonizojnë statutet e veta me këtë ligj brenda afatit prej 20 ditësh nga dita e konstituimit të tyre.

Këshillat kombëtare kanë për detyrë që punën e organeve të veta ta harmonizojnë me këtë ligj jo më vonë se 40 ditë nga konstituimi i këshillave kombëtare në pajtim me këtë ligj.

Ministri ka për detyrë që të miratojë aktet e parashikuara me këtë ligj brenda afatit prej 60 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

## **Neni 68**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga data e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë".